

Bashkim Azemi & Bekim Morina

Aparatura didaktike në tekstet shkollore

Prishtinë, 2013

Botues:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Autorë:

M. Sc. Bashkim Azemi

M. Sc. Bekim Morina

Kryeredaktor:

M. Sc. Nezir Çoçaj

Lektor:

Bekim Morina

Redaktor teknik:

Skender Mekolli

Përmbajtja

Parathënie.....	7
Hyrje.....	9
I. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	11
1. Ideja për të hulumtuar	11
2. Përkufizimi i tekstit shkollor.....	12
3. Përkufizimi i nocionit aparaturë didaktike	14
4. Rëndësia e hulumtimit.....	15
5. Qëllimi i hulumtimit.....	16
6. Objekti i hulumtimit.....	16
7. Objektivat e hulumtimit	16
8. Fazat e hulumtimit dhe detyrat e hulumtuesve.....	17
9. Hipoteza e hulumtimit.....	18
10. Metodadat, teknikat dhe instrumentet e hulumtimit	19
11. Popullata e hulumtimit dhe kampioni	19
12. Analiza e të dhënave	20
13. Kufizimet e hulumtimit	21
II. REZULTATET E HULUMTIMIT DHE INTERPRETIMI I TYRE.....	22
1. Rezultatet e hulumtimit kabinetik.....	23
1.1. Aparatura didaktike e Leximit letrar 6.....	23
1.2. Aparatura didaktike e Leximit letrar 7.....	24
1.3. Aparatura didaktike e Leximit letrar 8.....	25
1.4. Aparatura didaktike e Leximit letrar 8, teksti alternativ	26
1.5. Aparatura didaktike e Leximit letrar 9.....	26

1.6. Dallimet e aparaturës didaktike sipas teksteve (klasave).....	27
2. Rezultatet e hulumtimit nga pyetëtori me nxënës	29
2.1. Mendimet e nxënësve për rëndësinë e aparaturës didaktike	30
2.2. Mendimet e nxënësve për pajisjen e teksteve me aparaturë didaktike.....	31
2.3. Mendimet e nxënësve për ndërlidhjen e aparaturës didaktike me përmbajtjen	32
2.4. Mendimet e nxënësve për rëndësinë e ilustrimeve dhe fotove	33
2.5. Mendimet e nxënësve për rëndësinë e pyetjeve dhe detyrave.....	34
2.6. Mendimet e nxënësve për rëndësinë që u kushtojnë mësimdhënësit pyetjeve në tekst	35
2.7. Mendimet e nxënësve për fjalorët në tekstet shkollore (fjalët e panjohura dhe fjalët e reja).....	36
2.8. Mendimet e përgjithshme të nxënësve për aparaturën didaktike të teksteve shkollore.....	37
2.9. Mendimet e nxënësve për tekstin me aparaturën më të mirë didaktike	39
2.10. Rekomandimet e nxënësve për ndryshime të aparaturës didaktike	40
3. Rezultatet e hulumtimit nga pyetëtori me mësimdhënës	42
3.1. Mendimet e mësimdhënësve për pajisjen e teksteve shkollore me aparaturë didaktike.....	42
3.2. Mendimet e mësimdhënësve për rëndësinë e aparaturës didaktike	43

3.3. Mendimet e mësimitdhënësve për ndërlidhjen e aparaturës didaktike me përmbajtjen e tekstit	44
3.4. Mendimet e mësimitdhënësve për rëndësinë e ilustrimeve në tekstet shkollore	45
3.5. Mendimet e mësimitdhënësve për rëndësinë e pyetjeve në tekstet shkollore	46
3.6. Sugjerimet e mësimitdhënësve për ndryshime të aparaturës didaktike	47
3.7. Teksti më i mirë, sa i përket aparaturës didaktike, sipas mësimitdhënësve.....	49
4. Rezultatet e hulumtimit nga pyetësi me autorë të teksteve.....	50
4.1. Mendimet e autorëve për rëndësinë e aparaturës didaktike në tekstet shkollore	51
4.2. Mendimet e autorëve për pajisjen e teksteve me aparaturë didaktike.....	51
4.3. Mendimet e autorëve për ndërlidhjen e aparaturës didaktike me përmbajtjen	51
4.4. Mendimet e autorëve për rëndësinë e ilustrimeve, pyetjeve, detyrave dhe fjalorëve	52
4.5. Mendimet e autorëve për përshtatjen e aparaturës didaktike me përmbajtjen e tekstit.....	53
4.6. Sugjerimet dhe propozimet e autorëve për ndryshime të aparaturës	54
5. Rezultatet nga fokus-grupet me nxënës, mësimitdhënës dhe autorë të teksteve	55
5.1. Mendimet dhe propozimet e nxënësve	55
5.2. Mendimet dhe propozimet e mësimitdhënësve.....	56
5.3. Mendimet dhe propozimet e autorëve	57

6. Rezultatet nga protokoli i vëzhgimit të mësimdhënësve	58
6.1. Vëzhgimi i mësimdhënësve të klasës së gjashtë.....	59
6.2. Vëzhgimi i mësimdhënësve të klasës së shtatë.....	60
6.3. Vëzhgimi i mësimdhënësve të klasës së tetë	62
6.4. Vëzhgimi i mësimdhënësve të klasës së nëntë	64
6.5. Rezultatet e përgjithshme nga vëzhgimi i mësimdhënësve.....	65
IV. ANALIZA E REZULTATEVE TË PËRGJITHSHME TË HULUMTIMIT	67
1. Përfundimet.....	71
2. Rekomandimet	74
BIBLIOGRAFIA.....	77

Parathënie

Pas hartimit të kurrikulës së re, e cila bazohet në kompetenca, një ndër objektivat themelore do të jetë edhe hartimi i teksteve të reja shkollore, të cilat janë pjesë përbërëse e realizimit të procesit mësimor në shkolla. Brenda teksteve shkollore, aparatura didaktike zë një vend tejet të rëndësishëm, prandaj gjithnjë duhet të jetë në funksion të tekstit dhe në funksion të mësimdhënësve e të nxënësve, për punë më atraktive dhe më të lehtë me tekstin.

Gjatë analizës së teksteve shkollore kemi vërejtur se strukturës metodike nuk i kushtohet mjaft kujdes nga autorët, të cilët më tepër orientohen nga përmbajtja e tekstit, nga niveli i tij shkencor, duke e anashkuar shpesh aparaturën didaktike, edhe pse ajo e bën tekstin shkollor më efikas dhe është në funksion të të kuptuarit të përmbajtjes.

Meqë teksti shkollor ende mbetet pothuajse mjete i vetëm mësimor për një pjesë të madhe të mësimdhënësve tanë, përmirësimi i mësimdhënies varet në masë të konsiderueshme nga formësimi didaktik i teksteve, pajisja me aparaturë të qëlluar didaktike.

Tekstet shkollore përmbajnë aparaturë didaktike, por shpeshherë jo të qëlluar dhe jo të bollshme, prandaj, duke e ditur se deri më tani në Kosovë nuk është bërë ndonjë hulumtim për aparaturën didaktike në tekstet shkollore, që të vlerësohet rëndësia që i kushtojnë autorët, mësimdhënësit dhe nxënësit, qëllimi i këtij hulumtimi ishte të kuptojmë se sa është e ndërlidhur aparatura didaktike me përmbajtjen e teksteve shkollore dhe sa i kushtojnë rëndësi mësimdhënësit, nxënësit

dhe autorët asaj: ilustrimeve, fjalorëve, pyetjeve, detyrave, komenteve dhe shembujve.

Ky studim është një përpjekje për të vlerësuar rëndësinë e aparaturës didaktike në tekstet shkollore, prandaj, përveç analizës kabinetike, hulumtimit me pyetësorë, kemi organizuar punëtori me fokus-grupe, në të cilat pjesëmarrës kanë qenë nxënësit, mësimdhënësit dhe autorët e teksteve të leximit letrar, klasat 6, 7, 8 dhe 9. Po ashtu, i kemi vëzhguar mësimdhënësit në orët mësimore, për të kuptuar se sa i kushtojnë rëndësi aparaturës didaktike në tekstet shkollore.

Në bazë të hulumtimit kabinetik, që ua kemi bërë këtyre teksteve¹, vërehet se përmbajnë pjesë të ndryshme të aparaturës didaktike, por edhe mangësi të konsiderueshme gjatë hartimit të teksteve shkollore.

Përgjigjet e nxënësve dhe të mësimdhënësve janë krahasuar me mendimet e autorëve dhe të recensentëve të teksteve sa i përket aparaturës didaktike dhe mbi bazën e rezultateve të dalja janë nxjerrë edhe konkluzionet dhe rekomandimet për ndryshimet e nevojshme gjatë ribotimit, apo hartimit të teksteve të reja shkollore.

¹Instituti Pedagogjik i Kosovës (2009). Kërkime Pedagogjike 1, Prishtinë.

Hyrje

Kohët e fundit janë shtruar një varg çështjesh që lidhen me mënyrën e hartimit të teksteve, të cilat ndërlidhën me autorët e teksteve dhe shtëpitë botuese, e herë-herë edhe me tërësinë e përmbajtjeve që përfshihen në to, megjithatë ende, deri më tani, temë e debatit nuk ka qenë aparatura didaktike në tekstet shkollore.

Të qenit në dijeni të problemeve është një prej elementeve që ndihmon në hartimin e strategjive dalëse, për dallim nga injorimi i problemeve, prandaj, duke e ditur ndikimin e madh që kanë tekstet shkollore në formimin e nxënësve, rëndësinë e përfshirjes dhe ndërlidhjes së aparaturës didaktike me përmbajtjen, përgjegjësia e autorëve të teksteve duhet të jetë më e madhe që aparatura didaktike të jetë e përzgjedhur dhe e përshtatshme me përmbajtjen e tekstit dhe moshën e nxënësve. Rëndësia e aparaturës didaktike është e padiskutueshme, ngase i ndihmon mësimdhënësit në shpjegimin e përmbajtjeve mësimore dhe bën që ora të jetë e tërheqëse dhe më frytdhënëse. Roli i aparaturës nuk shihet vetëm në shtjellimin e njësisë mësimore, por edhe në fazat e tjera të orës, madje edhe në vlerësim. Krahas ndihmës së mësimdhënësit gjatë shpjegimit të njësisë mësimore, aparatura e qëlluar ndihmon edhe në kuptimin dhe interpretimin e përmbajtjes nga vetë nxënësit.

Përmbajtja e një njësie mësimore kërkon aparaturë didaktike të përshtatshme, duke filluar nga ilustrimet, detyrat, pyetjet dhe fjalorët. Aparatura didaktike e përzgjedhur dhe e vendosur mirë në një tekst shkollor nxit kureshtjen e nxënësve dhe shton interesimin e tyre, prandaj nga mësimdhënësi kërkohet ta

përdorë atë në kohën e duhur, duke e interpretuar bindshëm dhe duke e ndërlidhur çdoherë me përmbajtjen, në mënyrë që mësimi të jetë sa më atraktiv.

Aparatura i nxit nxënësit ta përvetësojnë më lehtë përmbajtjen mësimore, duke mos harruar rolin e mësimdhënësit, i cili e ka për detyrë të stimulojë nxënësit që të jenë çdoherë aktivë dhe të interesuar për mësim.

Përmirësimi i aparaturës didaktike, korrigjimi i qasjeve në disa aspekte dhe futja e qasjeve inovative, janë të domosdoshme në kohën e rishikimit të këtyre teksteve, ngase teksti në çdo njësi mësimore ngërthen në vete foto dhe ilustrime, pyetje dhe detyra, si dhe fjalë të panjohura, të cilat autori duhet t'i marrë për bazë, me qëllim të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore nga nxënësit.

Teksti në shumicën e rasteve mbetet burimi elementar prej nga nxënësi merr njohuri, prandaj hartimi i tij duhet t'u përshtatet edhe parametrave të përcaktuar, standardeve të teksteve etj.

Nevoja e hartimit të teksteve të reja me një mbështetje më të madhe të aparaturës didaktike, përveç mbështetjes në kurrikulën e re, duhet të ndërlidhet edhe me futjen e teknologjisë informative, përshtatjen e mësimdhënies me metodat dhe teknikat e reja të të mësuarit (të mësuarit problemor, sipas roleve, me projekte etj).

I. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

1. Ideja për të hulumtuar

Tekstet shkollore janë pjesë përbërëse dhe shumë e domosdoshme e procesit mësimor, prandaj mungesa e hulumtimeve lidhur me aparaturën didaktike që përmbajnë tekstet shkollore, me gjithë rëndësinë e saj, na shtyri të analizojmë dhe të krahasojmë aparaturën të cilën e përmbajnë tekstet e Letërsisë shqipe në arsimin e mesëm të ulët dhe pastaj të bëjmë një hulumtim me nxënës, mësimdhënës dhe autorë të teksteve.

Mendojmë se studimi ka një rëndësi të veçantë, për faktin se që nga fillimi i reformës arsimore në Kosovë nuk ka pasur asnjë studim të mirëfilltë për aparaturën didaktike në tekstet shkollore. Po ashtu, punimi është në relacion me projektet të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, për faktin se pas hartimit të kurrikulës kërkohet rishikimi i teksteve shkollore, pra kurrikula e re e bën të domosdoshëm edhe ndryshimin e teksteve shkollore (sidomos sa i përket aparaturës didaktike).

Edhe pse aparatura didaktike tekstin shkollor e bën efikas dhe është në funksion të kuptuarit më të lehtë të përmbajtjes, ajo është fushë e pastudiuar te ne, ngase deri më tani janë trajtuar problemet e përgjithshme të teksteve shkollore, në seminare dhe konferenca të ndryshme, por jo aparatura didaktike si dukuri e veçantë. Mund të thuhet se deri më tani nuk është dhënë asnjë kumtesë e tërësishme për këtë problem, ndërsa hulumtimet dhe studimet e mirëfillta kanë munguar. Në shumë

punime gjejmë vetëm ndonjë fjali që flet për rolin dhe funksionin e aparaturës didaktike në tekstet shkollore².

Ky hulumtim është një përpjekje për të provuar sadopak mundësitë e njohjes dhe favorizimit të aparaturës didaktike, në funksion të lehtësimit të përmbajtjes, për hartuesit e teksteve shkollore, për mësimmshënësit dhe në veçanti për nxënësit.

2. Përkufizimi i tekstit shkollor

Në kontekstin e mësimit në shkollë, termat *libër* dhe *tekst* janë të njëjtë. Megjithatë, termi *tekst* ka një karakter më zyrtar, ndërsa termi *libër* më pak zyrtar. Shkolla legalizon porosinë për tekstet, por nxënësi shprehet se ai e ka librin e tij.

Sipas fjalorit të gjuhës shqipe, fjala tekst do të thotë:

1. Materiale të shkruara ose të shtypura për studimin e diçkaje, lëndë mësimore e shkruar ose e shtypur në një libër a në një dispensë; pjesë të shkëputura nga një ose nga disa vepra letrare të shtypura së bashku për qëllime mësimore; libër, dispensë, përmbledhje etj., që përmban këto materiale. P.sh tekst mësimor;
2. Pjesë e një materiali të shkruar ose të shtypur pa shënimet e shpjegimet për të, pjesë e një libri pa parathënien ose pasthënien, pa titujt e kapitujve etj. Teksti dhe fotografitë (ilustrimet, skicat). Tekst me shënime (me shpjegime)³.

Teksti shkollor është libër (që ndryshon nga librat e tjerë në përdorim) themelor për secilën lëndë, i shkruar në bazë të

² Ramaj Abdyl (2001). "Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor", Libri Shkollor, Prishtinë.

³ FGJSSH, version elektronik.

planit dhe të programit mësimor, në të cilin përmbajtjet i ofrohen nxënësit me aparaturë didaktike të rregulluar, me qëllim që nxënësit t'i përvetësojnë dituritë e nevojshme, t'i zhvillojnë aftësitë e tyre dhe kulturën e punës, duke ofruar material për punë të pavarur dhe krijuese.

Recensenti e vlerëson shoqërimin e përmbajtjes dhe të ilustrimeve me aparaturë didaktike⁴.

Teksti përdoret në të gjitha fazat e realizimit të një ore mësimore nga mësimdhënësit dhe nxënësit, por, gjithashtu, mund të përdoret edhe jashtë procesit mësimor të rregullt, në procesin e vetëpërgatitjes së nxënësit për mësim, në shtëpi etj.

Teksti mësimor u shërben njëkohësisht:

- Arsimitarëve, për përgatitjen, organizimin dhe zhvillimin e mësimdhënies dhe shtjellim të diturive, në formë të sistematizuar dhe të përmbledhur;
- Nxënësve, për përdorim të përditshëm, për arsimimin e tyre, si burim themelor për përvetësimin e diturive për lëndën e caktuar në shkollë dhe për përsëritje dhe ushtrime në shtëpi.

Sipas UNESCO-s, tekstet shkollore duhet të nxisin çdo element të procesit të nxënies dhe roli i tyre të mos kufizohet vetëm mbi nxënien e njohurive faktike, si cilësi që nxit aktivisht nxënësin drejt procesit të ndërtimit të dijeve, shkathtësive dhe qëndrimeve të nevojshme për t'u bërë qytetar i përgjegjshëm në komunitetin ku jeton⁵.

⁴ Ligji për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik, nr. 02/L-67, qershor, 2006.

⁵ Pëllumb Karameta, "Teksti mësimor nuk po e bën punën e tij" [\(02. 07. 2013\)](http://www.qshaa.org)

3. Përkufizimi i nocionit aparaturë didaktike

Aparaturë didaktike në një tekst shkollor konsiderohen të gjitha ato pjesë përcjellëse që nuk janë tekst themelor, por që janë në funksion të tekstit mësimor, të cilat kontribuojnë për kuptimin më të mirë të informacioneve të tij, si: pyetjet, detyrat, shprehjet, fjalori, ilustrimet, biografite, komentet, udhëzimet etj.

Të gjitha këto e bëjnë tekstin shkollor më të kuptueshëm, më atraktiv dhe më tërheqës për nxënësit dhe u ndihmojnë atyre të përgatiten për punë të pavarur, për të menduarit kritik dhe për pasurim të fjalorit me fjalë dhe shprehje të reja.

Përmbajtjet mësimore janë të shumëllojshme dhe për përpunimin e tyre nuk mund të merret një model universal i strukturës së brendshme, e më këtë edhe i aparaturës didaktike që e përcjell, ose që është mbështetëse e përmbajtjeve mësimore, pasi në procesin e hartimit të një teksti mësimor ndikim ka edhe programi mësimor, mbi bazën e të cilit shkruhet teksti shkollor. Gjithashtu, gjatë formësimit didaktik të tekstit shkollor merren parasysh edhe aspekti njohës, logjik, psikologjik, psikolinguistik etj.

Në literaturën pedagogjike nocionin aparaturë didaktike të tekstit shkollor e gjejmë të përkufizuar edhe si:

- **Instrumentarium** (që në gjuhën shqipe mendojmë se nuk është adekuat);
- **Tekst plotësues** (nuk e plotëson nocionin e aparaturës didaktike, sepse, përveç pjesëve tekstuale, teksti ka edhe elemente ilustrative, grafike);

- **Aparat i organizimit të përvetësimit të lëndës** (gjithashtu konsiderojmë se nuk e plotëson, sepse, përveç përvetësimit të njohurive, teksti shkollor ka edhe funksion nxitës, praktik);
- **Elemente strukturore stimulative** (konsiderojmë se ky përkufizim është mjaft i ngushtë dhe nuk e përfshin tërë aparaturën didaktike të tekstit shkollor, megjithëse teksti një ndër qëllimet e ka edhe stimulimin e nxënësit për të mësuar, me anë të ilustrimeve, fjalorëve, pyetjeve, detyrave etj.).

4. Rëndësia e hulumtimit

Studimi ndërlidh aspektet teorike dhe praktike të përdorimit të aparaturës didaktike në tekstet shkollore, prandaj rëndësia e këtij hulumtimi është e madhe, për faktin se krijon mundësi për të nxjerrë të dhëna reale për aparaturën e përdorur në tekstet shkollore dhe siguron informacion për grupet e interesit, si: mësimmhënësit, nxënësit, autorët e teksteve, recensentët, shtëpitë botuese (të teksteve shkollore), MASHT-in etj.

Mbi bazën e gjetjeve nga hulumtimi, ofrohen rekomandime të rëndësishme për rishikimin dhe përmirësimin e hartimit të teksteve shkollore me aparaturë didaktike adekuate, e cila zë një vend tejet me rëndësi për nxënien e njohurive nga nxënësit. Hulumtimi synon të përmirësojë efektivitetin e përdorimit të aparaturës didaktike në tekstet shkollore dhe për ta bërë këtë zakonisht kërkohet opinionin e mësimmhënësve dhe nxënësve.

Ky opinion mundëson të vlerësohet drejt nëse tekstet shkollore kanë aparaturë didaktike të mjaftueshme dhe të përshtatshme për nxënësit.

Ndikimi i këtij hulumtimi në zgjidhjen e përmasës së problemit mendojmë se është i madh, për faktin se nga përdorimi adekuat i aparaturës didaktike varet edhe mësimdhënia e mirë, si dhe motivimi i nxënësve në procesin e të nxënësve.

5. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit ishte të vlerësohet rëndësia e aparaturës didaktike në tekstet shkollore, gjegjësisht sa i kushtojnë rëndësi aparaturës didaktike autorët gjatë hartimit të teksteve shkollore, mësimdhënësit gjatë shpjegimit dhe nxënësit gjatë përdorimit të tyre.

6. Objekti i hulumtimit

Objekt i hulumtimit ishin tekstet shkollore (librat e Leximit letrar, klasat VI, VII, XIII, IX), me theks të veçantë ato që janë në përdorim aktualisht në shkollat tona në arsimin e mesëm të ulët.

7. Objektivat e hulumtimit

Objektiva e përgjithshme e hulumtimit ishte të vlerësohet se sa ndikon aparatura didaktike e teksteve shkollore në mësimdhënie dhe nxënie, ndërsa objektivat specifike në këtë hulumtim do të reflektojnë vlerësimin e aparaturës didaktike në tekstet shkollore (Leximi letrar 6, 7, 8 dhe 9).

8. Fazat e hulumtimit dhe detyrat e hulumtuesve

Fazat e realizimit të hulumtimit:

Në fazën e parë është bërë hulumtimi kabinetik, analiza e teksteve shkollore që aktualisht janë në përdorim dhe konsultimi i literaturës së nevojshme.

Në fazën e dytë kemi realizuar hulumtimin empirik në terren - me nxënës, mësime dhe autorë të teksteve - për të marrë mendimet e tyre për aparaturën didaktike.

Në fazën e tretë kemi mbajtur një punëtori me fokus-grupe, në të cilën kanë marrë pjesë nxënës, mësime dhe autorë të teksteve. Në fazën e katërt kemi bërë vëzhgimin e mësimeve në orët mësimore, për të parë nga afër se sa i kushtohet rëndësi aparaturës didaktike gjatë shpjegimit të njësive mësimore.

Detyrat e hulumtuesve:

Nga qëllimi i hulumtimit kanë dalë edhe detyrat e hulumtuesve. Së pari, u kemi bërë një vështrim kritik teksteve të letërsisë dhe në bazë të këtij vështrimi e kemi analizuar dhe krahasuar aparaturën e përdorur në tekstet shkollore, për të kuptuar se çfarë aparaturë didaktike përmban secili tekst i letërsisë, sipas klasave.

Së dyti, me anë të pyetësorëve të veçantë për mësime dhe nxënës kemi marrë mendimet e tyre, se sa janë të kënaqur me aparaturën didaktike që përmbajnë këto tekste dhe si ndikon ajo në mësime dhe në nxënie.

Për të arritur këtë na është dashur që:

- Të përgatiten instrumentet e hulumtimit;

- Të merren opinionet nga mësime dhe nxënësit për rëndësinë e aparaturës didaktike në procesin e mësimdhënies dhe nxënies;
- Të merren opinionet nga mësime dhe nxënësit se sa është aparatura didaktike në funksion të tekstit mësimor;
- Të merren opinionet nga autorët e teksteve dhe recensentët për rëndësinë që ata i kushtojnë përdorimit të drejtë të aparaturës didaktike gjatë hartimit, gjegjësisht recensimit të teksteve;
- Të përpunohen dhe të analizohen të dhënat e pyetësorëve.

Së treti, përmes punëtorisë së mbajtur me fokus-grupe, rezultatet e përgjithësuara nga pyetësorët i kemi diskutuar me mësime dhe nxënësit dhe autorë tekstesh, për të marrë mendimet dhe sugjerimet e tyre për çështjet e ngritura për diskutim.

Së katërti, i kemi vëzhguar mësime dhe nxënësit në orë se sa në të vërtetë e shfrytëzojnë aparaturën didaktike në tekstet shkollore, gjatë mësimdhënies.

Së pesti, kemi analizuar dhe interpretuar rezultatet e përgjithshme të hulumtimit dhe mbi bazën e tyre i kemi nxjerrë sugjerimet dhe rekomandimet për ndryshimet që do të duhej të bëheshin në tekste shkollore në të ardhmen, gjatë ribotimit, apo hartimit të teksteve të reja.

9. Hipoteza e hulumtimit

Aparatura didaktike në tekstet shkollore e bën më të lehtë, më të kuptueshëm dhe më të qartë tekstin (e lehtëson të kuptuarit e përmbajtjes).

10. Metodatat, teknikat dhe instrumentet e hulumtimit

Duke pasur për bazë qëllimin e hulumtimit - sigurimin e të dhënave të mjaftueshme dhe të besueshme, kemi përdorur metodën e analizës së dokumentacionit, metodën e anketimit, metodën statistikore dhe atë të fokus-grupeve.

Kurse, sa u përket teknikave, kemi përdorur teknikën e analizës së dokumentacionit, teknikën e punës me pyetësorë, teknikën e punës me fokus-grupe dhe teknikën e vëzhgimit.

Instrumentet për mbledhjen e të dhënave ishin: protokollit i analizës së dokumenteve (librave shkollore), fletëpyetësorët për mësimdhënësit, nxënësit dhe autorët e teksteve, diktafoni për regjistrimin e të dhënave nga fokus-grupet, si dhe protokollit i vëzhgimit.

11. Popullata e hulumtimit dhe kampioni

Hulumtimi është realizuar në shkallë vendi, andaj popullacionit i hulumtimit ishin të gjithë mësimdhënësit e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe, të gjithë nxënësit e shkollave të mesme të ulëta të Kosovës, si dhe autorët e teksteve që ishin në fokus të hulumtimit.

Hulumtimi me pyetësorë është realizuar në 14 shkolla, në 14 komuna të Kosovës, në vendbanime urbane dhe rurale, me kampion 24 mësimdhënësit të nivelit të mesëm të ulët, 214 nxënësit të nivelit të mesëm të ulët (klasat 6, 7,8 dhe 9) dhe 6 autorët e këtyre teksteve,.

Ndërsa, në punëtorinë me fokus-grupe janë përzgjedhë 10 mësimdhënësit dhe 10 nxënësit të shkollave të ndryshme dhe autorët e teksteve.

Po ashtu, janë vëzhguar në orë mësimore, gjatë shpjegimit, 8 mësimdhënës të shkollave të mesme të ulëta, nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë, në disa komuna të Kosovës.

12. Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave është bërë me qëllim që të përshkruhen dhe të vlerësohen përgjigjet e nxënësve, mësimdhënësve dhe autorëve për pyetjen kërkimore në hulumtim, për rëndësinë e aparaturës didaktike në tekstet shkollore në lehtësimin e të kuptuarit të përmbajtjes së tekstit.

Meqë instrumentet që janë përdorur për mbledhjen e të dhënave ishin statistikore dhe tematike, gjegjësisht të përmbajtjes, na është dashur të bëjmë analiza cilësore dhe sasiore.

Të dhënat e përgjithësuara jemi përpjekur t'i analizojmë në mënyrë të kujdesshme dhe të besueshme.

Faktikisht, analiza kualitative në këtë hulumtim është ajo e të dhënave që përbëhen nga përgjigjet në pyetësorë, në fokus-grupe, dhe vëzhgimi që ua kemi bërë mësimdhënësve gjatë shpjegimit në orët mësimore.

Interpretimi është bërë në mënyrë që të krijohet një rend dhe kuptueshmëri e tyre, sipas qasjes së përzgjedhur.

Ndërsa, analiza kuantitative është bërë duke paraqitur përqindjen në grafike të aparaturës didaktike në çdo tekst (libër leximi), sipas klasave. Po ashtu, edhe përgjigjet e nxënësve dhe të mësimdhënësve të dhëna në pyetësorë sipas klasave.

Procesi i analizës së të dhënave në hulumtim është bërë sipas disa hapave:

Hapi i parë - i kemi analizuar të dhënat, të cilat janë lexuar dhe rilexuar, në mënyrë që të kuptohet qartësia e të tyre.

Hapi i dytë - analiza është fokusuar në pyetjen kërkimore, pra e kemi ditur saktësisht se çka dëshirojmë të dimë dhe të kuptojmë dhe paraprakisht i kemi identifikuar pyetjet ndihmëse, së cilave mbi bazën e të dhënave dëshironim t'u jepnim përgjigje.

Hapi i tretë - kategorizimin e të dhënave gjatë analizës në tërësi e kemi ndarë në përgjigje të nxënësve, të mësimdhënësve dhe të autorëve të teksteve, si dhe kemi bërë krahasimin e tyre dhe kemi nxjerrë dallimet në përgjigje.

Hapi i katërt - gjatë interpretimit jemi munduar të shpjegojmë të gjeturat që janë të rëndësishme, të cilat ishin rrjedhojë e kategorizimit dhe seleksionimit, të cilat, sipas mendimit tonë, janë kryesore dhe mjaft me rëndësi për hulumtimin.

Interpretimin e të dhënave e kemi plotësuar edhe me anë të grafikeve të ndryshme dhe treguesve të përqindjeve statistikore.

13. Kufizimet e hulumtimit

Gjatë realizimit të hulumtimit kemi pasur edhe disa kufizime, të cilat, kryesisht, ndërlidhen me aspektin e mbështetjes financiare.

Shkaku i buxhetit të kufizuar për hulumtime, na është kufizuar mundësia e përfshirjes së një numri më të madh të mësimdhënësve dhe nxënësve në hulumtim.

Si kufizim tjetër ishte edhe mungesa e literaturës së bollshme dhe hulumtimeve apo analizave të bëra për problematikën në fjalë, ngase deri më tani kanë munguar hulumtimet empirike për aparaturën didaktike në tekstet shkollore.

II. REZULTATET E HULUMTIMIT DHE INTERPRETIMI I TYRE

Kërkesat themelore didaktike për hartimin e një teksti shkollor janë që përmbajtja mësimore të bëhet më e lehtë dhe më e kuptueshme, si për nxënësit po ashtu edhe për mësimdhënësit: me anë të ilustrimeve, fjalorëve, pyetjeve, detyrave dhe formësimit grafik.

Formësimi didaktik i teksteve shkollore synon që nxënësit të aftësohen për të fituar dituri të reja, të punojnë të pavarur dhe pa vështirësi, por tekstet shkollore tradicionale nuk kanë formësim të duhur didaktik, përkatësisht aparaturë të mjaftueshme didaktike për të arritur këtë.

Aparatura didaktike në disa tekste nuk është e përzgjedhur si duhet dhe jo gjithmonë nxënësit i vë në situatë që të punojnë të pavarur, të mendojnë në mënyrë kritike, të debatojnë, të eksperimentojnë dhe të aplikojnë në praktikë njohuritë e dhëna në tekst, por vetëm t'i mësojnë përmendësh ato.

Në vazhdim kemi paraqitur rezultatet e dala nga hulumtimi kabinetik (analiza e teksteve shkollore të letërsisë, klasat VI, VII, VIII dhe IX), për të parë se sa janë të pajisura tekstet me aparaturë didaktike (ilustrime, foto, fjalorë, detyra, pyetje...), çfarë aparature përmbajnë, sa është e lidhur ajo me përmbajtjen e teksteve, sa i kushtojnë rëndësi autorët gjatë hartimit të teksteve dhe mësimdhënësit e nxënësit gjatë procesit mësimor.

Po ashtu, i kemi nxjerrë dallimet dhe ngjashmëritë që ato kanë, përparësitë dhe dobësitë, sipas autorëve, mësimdhënësve dhe nxënësve.

Përveç rezultateve të hulumtimit kabinetik, i kemi paraqitur edhe rezultatet nga hulumtimi empirik - me pyetësorë dhe

fokus-grupe, si dhe nga vëzhgimi i mësimdhënësve në orët mësimore.

1. Rezultatet e hulumtimit kabinetik

Para se të fillohet me hulumtimin në terren, është bërë një studim kabinetik, me ç'rast janë analizuar tekstet aktuale të Letërsisë, për të parë se sa janë të pajisura me aparaturë didaktike, çfarë aparature përmbajnë etj.

Në tekstet Leximi letrar, në të katër klasat (VI, VII, VIII dhe IX), vërehen dallime në përdorimin e aparaturës didaktike, duke filluar nga njësitë mësimore.

Më së shumti njësi përmban teksti i klasës së gjashtë. Teksti i klasës së shtatë ka më pak njësi mësimore, por në tekstin e klasës së tetë vërehet prapë një rritje e njësive mësimore, kurse në atë të klasës së nëntë hasim një numër më të vogël të njësive mësimore.

Dallime të shumta vërehen edhe te pjesët e tjera të aparaturës didaktike: ilustrimet dhe fotot, fjalorët, biografitë, pyetjet, detyrat etj.

Sa i përket pajisjes së teksteve me aparaturë didaktike, i kemi vrojtuar (analizuar) të gjitha tekstet me kujdes, për të parë se çfarë aparature didaktike përmban secili tekst, si dhe cilat janë dallimet dhe ngjashmëritë.


1.1. Aparatura didaktike e Leximit letrar 6

Leximi letrar i klasës së gjashtë përmban gjithsej 358 njësi të aparaturës didaktike. Prej tyre, 52 njësi mësimore, 37 fjalorë, 64 ilustrime dhe foto, 26 biografi, 53 kuptojmë tekstin, 30

vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, 49 studiojmë gjuhën e tekstit dhe 47 detyra.

Ky tekst, për dallim nga tekstet e tjera, është mjaft i pasur me detyra. Pothuajse në fund të çdo njësie mësimore përmban detyra, e po ashtu jepen mjaft mirë edhe definicionet për çdo figurë letrare dhe njësi mësimore, si p.sh çfarë janë tema, ditari, letra, simboli, metafora, krahasimi, rima, drama, alegoria, shkrimi shkencor, etj.

Grafiku tregon aparaturën didaktike të tekstit në përqindje.




1.2. Aparatura didaktike e Leximit letrar 7

Leximi letrar i klasës së shtatë gjithsej përmban 292 njësi të aparaturës didaktike. Prej tyre, 40 njësi mësimore, 30 fjalorë, 61 ilustrime, 31 foto, 29 biografi, 2 detyra, 36 punë e pavarur, 22 të mësojmë me shumë, 39 të bisedojmë për tekstin - poezinë dhe 2 provo edhe këtë.

Për dallim nga Leximi letrar i klasës së gjashtë, teksti i klasës së shtatë përmban fare pak detyra, vetëm dy.


Grafiku tregon aparaturën didaktike të tekstit në përqindje.



1.3.Aparatura didaktike e Leximit letrar 8

Teksti Leximi letrar i klasës së tetë në përgjithësi ka një aparaturë më të pasur, krahasuar me Leximin letrar të klasës së shtatë, pasi përmban gjithsej 308 njësi të aparaturës didaktike. Prej tyre, 50 njësi mësimore, 35 punë e pavarur, 36 fjalorë, 70 ilustrime dhe foto, 39 biografi, 26 të mësojmë më shumë, 50 të bisedojmë dhe 2 detyra.

Grafiku tregon aparaturën didaktike të tekstit në përqindje.




1.4. Aparatura didaktike e Leximit letrar 8, teksti alternativ

Teksti Leximi letrari klasës së tetë - teksti alternativ, përmban aparaturën më të pasur, pasi gjithsej i ka 388 njësi të aparaturës didaktike. Prej tyre, 49 njësi mësimore, 20 detyra kreative, 49 fjalorë, 145 ilustrime dhe foto, 45 biografi, 20 të kuptojmë tekstin, 17 shembuj, 20 mendo dhe 23 detyra.

Ky tekst dallon nga të tjerët, sidomos sa i përket numrit të ilustrimeve dhe fjalorëve.

Grafiku tregon aparaturën didaktike të tekstit në përqindje.




1.5. Aparatura didaktike e Leximit letrar 9

Leximi letrar i klasës së nëntë përmban një aparaturë më të varfër krahasuar me leximin letrar të klasës së tetë, gjithsej 146 njësi të aparaturës didaktike, që do të thotë 50 % më pak.

Prej tyre, 35 njësi mësimore, 8 fjalorë, 18 ilustrime, 16 biografi, 28 detyra, 11 komente, 27 provoni dijen tuaj dhe 3 analiza.

Por, Leximi letrar i klasës së nëntë, edhe pse përmban më pak njësi mësimore, është më i pasur me detyra, që dallon nga Leximi letrar i klasës së tetë.

Grafiku tregon aparaturën didaktike të tekstit në përqindje.



1.6. Dallimet e aparaturës didaktike sipas teksteve (klasave)

Sa i përket aparaturës didaktike në këto tekste, dallimet më të mëdha i vërejmë te përdorimi i fjalorëve (fjalëve të panjohura). Derisa në tekstin e klasës së gjashtë dhe në tekstin e klasës së tetë gjenden fjalorë të përdorur, përafërsisht, në numër të njëjtë, teksti i klasës së shtatë ka më pak, kurse teksti i klasës së nëntë përmban më së paku fjalorë, në krahasim me tekstet e tjera.

Edhe sa i përket përdorimit të ilustrimeve dhe fotove dallimet janë po ashtu mjaft të dukshme. Në tekstin e klasës së gjashtë hasim një përdorim mesatar të ilustrimeve, derisa në atë të klasës së shtatë vërehet një përqindje më e lartë.

Teksti i klasës së tetë, po ashtu, nuk përmban shumë ilustrime, për dallim nga teksti alternativ, i cili ka më së shumti ilustrime dhe foto, kurse në tekstin e klasës së nëntë vërehet një përdorim shumë i vogël i ilustrimeve dhe fotove.


Biografite për shkrimtarët, po ashtu, dallojnë mjaft nga njëri tekst në tjetrin. Më së shumti biografi përmbajnë tekstet e klasës së tetë, kurse teksti i klasës gjashtë dhe i klasës së shtatë kanë një dallim të vogël, por te teksti i klasës së nëntë vërehet një dallim më i madh në krahasim me tekstet e klasave të tjera, pasi përmban më pak biografi.

Te detyrat kemi, gjithashtu, një dallim të madh. Derisa në tekstin e klasës së gjashtë vërehet numër më i madh i detyrave, te tekstet e klasës së shtatë dhe të klasës së tetë vërehet një numër shumë i vogël i detyrave, ndërsa në atë të klasës së nëntë kemi po ashtu një numër të madh.

Pjesët e tjera të aparaturës didaktike janë tërësisht të ndryshme në tekste. Për shembull, **kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, studiojmë gjuhën e tekstit**, i gjejmë vetëm në tekstin e klasës së gjashtë.

Punë e pavarur dhe mësojmë më shumë i gjejmë vetëm në tekstet e klasës së shtatë dhe të tetë, të cilat janë përafërsisht të njëjta në përdorim, ndërsa **të bisedojmë për tekstin dhe për poezinë** vërehet vetëm në tekstin e klasës së tetë (tekst alternativ). **Provo edhe këtë** e hasim vetëm në tekstin e klasës së shtatë, ndërsa **analiza, provoni dijen tuaj dhe komente** i gjejmë vetëm në tekstin e klasës së nëntë.

Grafiku tregon aparaturën didaktike që përbajnë të gjitha tekstet



2. Rezultatet e hulumtimit nga pyetësi me nxënës

Çfarë në të vërtetë kuptojmë me aparaturë didaktike të mirë në një tekst shkollos nuk është e lehtë të vlerësohet, megjithatë aparatura e mirë didaktike varet kryesisht nga lehtësimi i të kuptuarit të përmbajtjeve mësimore nga nxënësit.

Pyetësi na shërbeu për të marrë mendimet e nxënësve, në mënyrë që të kuptojmë se cilat janë përshtypjet e tyre për tekstet: A u paraqesin ato probleme gjatë të mësuarit? A janë të ndërlidhura sa duhet me përmbajtjen e tekstit? A janë të mbështetura sa duhet me aparaturë didaktike? A janë të pajisura mjaft me ilustrime, fjalorë, pyetje, detyra etj.?


Pra, pyetësi për nxënës është ndërtuar mbi bazën e disa pyetjeve, duke e ditur se nxënësit nuk e kuptojnë nocionin ‘aparaturë didaktike’. Është kërkuar mendimi i tyre për rëndësinë që i kushtojnë mësimit aparaturës didaktike, zbatimit të drejtë të saj në orët mësimore, si dhe sa i kushtojnë vetë nxënësit rëndësi gjatë punës me tekste.

Nga nxënësit është kërkuar edhe vlerësimi për tekstin më të mirë sa i përket aparaturës didaktike dhe sugjerimet e tyre për ndryshimet apo plotësimet e teksteve me aparaturë në të ardhmen.

2.1. Mendimet e nxënësve për rëndësinë e aparaturës didaktike

Pjesa më e madhe e nxënësve të përfshirë në hulumtim kanë thënë se aparatura didaktike në një tekst shkollor është mjaft e rëndësishme (ilustrimet, fotot, pyetjet, detyrat, fjalorët), ngase e bën më të kuptueshëm mësimin dhe më interesante përmbajtjen.


Përgjigjet e nxënësve në përqindje, sipas klasave



2.2. Mendimet e nxënësve për pajisjen e teksteve me aparaturë didaktike

Sa i përket pajisjes së teksteve me aparaturë didaktike, pjesa më e madhe e nxënësve të përfshirë në hulumtim kanë thënë se tekstet shkollore janë të pajisura me ilustrime, pyetje, detyra dhe fjalorë, ndërsa një numër më i vogël i nxënësve ka thënë se tekstet shkollore nuk kanë mjaft ilustrime, pyetje, detyra dhe fjalorë.


Përgjigjet e nxënësve në përqindje, sipas klasave



2.3. Mendimet e nxënësve për ndërlidhjen e aparaturës didaktike me përmbajtjen

Ndërlidhja e aparaturës didaktike (ilustrimeve, fotove, fjalorëve, pyetjeve dhe detyrave) me përmbajtjen, sipas përgjigjeve të nxënësve të përfshirë në hulumtim, është e kënaqshme në pjesën më të madhe të njësive mësimore, por, sipas tyre, ka edhe njësi mësimore në të cilat aparatura didaktike ndërlidhet pjesërisht ose nuk ndërlidhen fare me përmbajtjen e tekstit.

Përgjigjet e nxënësve në përqindje, sipas klasave




2.4. Mendimet e nxënësve për rëndësinë e ilustrimeve dhe fotove

Nxënësit janë përgjigjur se ilustrimet, fotot, grafiket, skicat, janë mjaft me rëndësi për ta dhe u kushtojnë shumë rëndësi, sepse e bëjnë më të lehtë mësimin dhe më interesante përmbajtjen.

Ilustrimet dhe fotot, sipas tyre, ndihmojnë mjaft në proceset njohëse të perceptimit, por edhe në përshkrimin, analizën dhe vlerësimin e përgjithësimin e përmbajtjes së tekstit.

Përgjigjet e nxënësve në përqindje, sipas klasave




2.5. Mendimet e nxënësve për rëndësinë e pyetjeve dhe detyrave

Sipas shumicës së nxënësve, pyetjet dhe detyrat që gjenden në tekst janë mjaft me rëndësi, ngase e bëjnë më të lehtë përvetësimin e përmbajtjes dhe më të kuptueshme njësinë mësimore.

Mbi 90 për qind kanë vlerësuar se pyetjet dhe detyrat e dhëna në tekstet shkollore e bëjnë më të lehtë kuptimin e përmbajtjes, ndërsa më pak se 10 për qind e tyre nuk e kanë vlerësuar rëndësinë e pyetjeve dhe detyrave të dhëna në tekst.

Përgjigjet e nxënësve në përqindje, sipas klasave




2.6. Mendimet e nxënësve për rëndësinë që u kushtojnë mësimdhënësit pyetjeve në tekst

Se sa i vlerësojnë mësimdhënësit pyetjet në tekst, gjegjësisht cilave pyetje u kushtojnë më shumë rëndësi gjatë vlerësimit të nxënësve, pyetjeve në tekst apo pyetjeve që i hartojnë vetë, kemi marrë këto përgjigje nga ana e nxënësve.

Mbi 70 për qind e nxënësve kanë thënë se mësimdhënësit bazohen në pyetjet e tekstit kur i pyesin ata, ndërsa rreth 30 për qind kanë thënë se mësimdhënësit i hartojnë vetë pyetjet, pa u bazuar në pyetjet e dhëna në tekst.

Përgjigjet e nxënësve në përqindje, sipas klasave



2.7. Mendimet e nxënësve për fjalorët në tekstet shkollore (fjalët e panjohura dhe fjalët e reja)

Sipas nxënësve, fjalorët e dhënë në tekstet shkollore u ndihmojnë mjaft për të kuptuar fjalët e panjohura, prandaj janë mjaft të rëndësishëm për ta.

Rreth 20 për qind e nxënësve janë shprehur se fjalorët e dhënë në tekste u ndihmojnë për të kuptuar të gjitha fjalët e panjohura. Ndërsa, 80 për qind e nxënësve janë përgjigjur se fjalorët e dhënë në tekste nuk janë çdoherë të mjaftueshëm për të gjitha fjalët e panjohura, apo shprehjet e reja, të cilat nxënësit i hasin në tekste, por vetëm për disa fjalë.

Përgjigjet e nxënësve në përqindje, sipas klasave



2.8.Mendimet e përgjithshme të nxënësve për aparaturën didaktike të teksteve shkollore

Në përgjithësi vlerësimet e nxënësve për aparaturën didaktike në tekstet shkollore - Libër leximi për klasat 6,7,8 dhe 9 - janë pozitive.

Lidhur me pajisjen e teksteve me aparaturë didaktike, pjesa më e madhe e nxënësve të përfshirë në hulumtim, gjegjësisht 76 për qind e nxënësve, kanë thënë se janë mjaft të pajisura, ndërsa 24 për qind kanë thënë se nuk janë të pajisura sa duhet.

Sipas mendimeve të nxënësve, aparatura që përmbajnë këto tekste shkollore është nxitëse për ta që të mësojnë nga libri. 79 për qind e nxënësve kanë thënë se ilustrimet dhe pjesët e tjera

të aparaturës didaktike i nxisin ata gjithherë për të lexuar, ndërsa 21 për qind kanë thënë se i nxisin ndonjëherë.

Nxënësit, po ashtu, e kanë vlerësuar edhe rëndësinë që i kushtojnë mësimdhënësit aparaturës didaktike gjatë shpjegimit të njësive mësimore.

66 për qind e tyre kanë thënë se mësimdhënësit i kushtojnë shumë rëndësi aparaturës didaktike gjatë shpjegimit, 31 për qind e nxënësve kanë thënë nuk i kushtojnë fare rëndësi, ndërsa vetëm 3 për qind kanë thënë se i kushtojnë rëndësi ndonjëherë.

Në përgjithësi, mendimi i nxënësve është se nga e gjithë aparatura didaktike që përmbajnë këto tekste më së shumti vlerësohen ilustrimet, pyetjet, detyrat dhe fjalorët.

Megjithatë, vërehen dallime në përgjigjet e nxënësve se cila është rëndësia e aparaturës didaktike: e bën më interesant mësimin apo më të kuptueshme përmbajtjen.

75 për qind e nxënësve kanë thënë se ilustrimet, pyetjet, detyrat dhe fjalorët në tekstin shkollor janë me rëndësi, sepse e bëjnë më interesant mësimin, ndërsa 25 për qind kanë thënë se e bëjnë më të kuptueshme përmbajtjen.

Rreth ndërlidhjes së aparaturës didaktike me përmbajtjen e njësive mësimore në tekstet shkollore kemi po ashtu përgjigje të ndryshme. 60 për qind e nxënësve kanë thënë se aparatura didaktike ndërlidhet me përmbajtjen në disa njësi mësimore, 35 për qind kanë thënë në të gjitha njësitë, ndërsa vetëm 5 për qind kanë thënë nuk ndërlidhet në asnjë njësi mësimore.

Për të kuptuar njësitë mësimore, sipas përgjigjeve të nxënësve, rëndësi të veçantë kanë fjalorët e dhënë në tekst.

78 për qind e nxënësve kanë thënë se fjalorët e dhënë në tekst u ndihmojnë vetëm për disa fjalë të panjohura, ndërsa 22 për qind kanë thënë se fjalorët u ndihmojnë për të kuptuar të gjitha fjalët e panjohura.

Fjalorët në tekstet shkollore u ndihmojnë mjaft për ta kuptuar përmbajtjen e mësuar, por vlerësimi i tyre ishte se fjalorët në tekstet shkollore nuk janë të mjaftueshëm dhe nuk u ndihmojnë për t'i kuptuar të gjitha fjalët dhe shprehjet e panjohura.

Pyetjet, detyrat dhe shembujt që gjenden në tekst janë me rëndësi për nxënësit, varësisht nga ajo se sa mësimdhënësit u përbahen kur i vlerësojnë njohuritë e tyre për njësitë mësimore.

Nga të gjithë nxënësit e përfshirë në hulumtim, 68 për qind e tyre kanë thënë se mësimdhënësit më tepër u kushtojnë rëndësi pyetjeve që gjenden në fund të tekstit (njësisë mësimore), ndërsa 32 për qind kanë thënë se mësimdhënësit nuk bazohen në pyetjet e dhëna në tekst, por i hartojnë vetë ato gjatë vlerësimit.

2.9. Mendimet e nxënësve për tekstin me aparaturën më të mirë didaktike


Nxënësit kanë dhënë vlerësime të ndryshme për tekstet nga të cilat kanë mësuar (jo vetëm për tekstin nga i cili mësojnë aktualisht, por edhe për tekstet e klasave paraprake).

Në pyetjen se cili nga tekstet Leximit letrar, prej të cilit keni mësuar deri më tani, mendoni se është më i lehtë për të kuptuar përmbajtjen e tij, kemi marrë këto vlerësime nga nxënësit: 56 nxënës e kanë vlerësuar më së shumti tekstin e klasës së gjashtë, 35 nxënës e kanë vlerësuar tekstin e klasës së shtatë, 54 nxënës e kanë vlerësuar tekstin e klasës së tetë.

Më së paku i vlerësuar nga nxënësit, sa i përket aparaturës didaktike që përmban, në krahasim me tekstet e tjera, është teksti i klasës së nëntë - vetëm nga 13 nxënës.

Një vlerësim të lartë sa i përket aparaturës didaktike nxënësit e kanë dhënë për tekstin alternativ (Leximi Letrar 8, nga autori Kujtim Rrahmani), gjegjësisht 55 nxënës.

Përgjigjet e nxënësve në përqindje, sipas klasave




2.10. Rekomandimet e nxënësve për ndryshime të aparaturës didaktike

Në pyetjen se çfarë do të ndryshonit në tekstin Leximi letrar, nëse do të kërkohej mendimi juaj, kemi marrë këto përgjigje (sugjerime) nga nxënësit:

Do të ndryshonim ilustrimet kanë thënë 96 nxënës, pyetjet kanë thënë 39, detyrat 58, fjalorët 72, fotot 7 nxënës, tekstet kanë thënë 14 nxënës, ndërsa nuk do të ndryshonim asgjë kanë thënë 9 nxënës.

28 nxënës të përfshirë në hulumtim janë shprehur se do të ishte mirë që librat të kishin një CD (e cila do t'u ndihmonte për recitim e poezive dhe shqiptimin e fjalëve drejt).

Grafiku në vazhdim tregon propozimet e nxënësve për ndryshimin e aparaturës didaktike në tekstet shkollore, sipas klasave



Nga përgjigjet e nxënësve mund të konstatojmë se aparatura didaktike në tekstet shkollore është mjaft e rëndësishme, sidomos ilustrimet, fjalorët, pyetjet dhe detyrat.

Ajo u ndihmon shumë nxënësve në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore që gjenden në tekst, por edhe mësimdhënësve gjatë shpjegimit të njësive mësimore.

Sipas nxënësve, në të ardhmen, kur të hartohen tekstet shkollore, apo gjatë ribotimit të këtyre teksteve, duhet t'u kushtohet më tepër rëndësi ilustrimeve dhe fjalorëve, por edhe pyetjeve dhe detyrave.

Sipas sugjerimeve të nxënësve, tekstet e klasës së gjashtë dhe të shtatë duhet të kenë më tepër ilustrime dhe foto, ndërsa pyetjet dhe detyrat të jenë më të pakta në numër, por më shumë ‘zbavitëse’, ndërsa tekstet për klasën e tetë dhe të nëntë të kenë më shumë pyetje e detyra dhe më pakë ilustrime dhe fjalorë.

Pra, në përgjithësi nxënësit kanë sugjeruar që aparatura didaktike t’u përshtatet moshës dhe paranjohurive të tyre, sipas klasave, dhe gjithnjë të jetë e ndërlidhur me përmbajtjen e tekstit.

3. Rezultatet e hulumtimit nga pyetësi me mësimdhënës

Për të marrë vlerësimet e mësimdhënësve për aparaturën didaktike në tekstet shkollore, kemi parashtruar një sërë pyetjesh në pyetësor.


Qëllimi i pyetësorit me mësimdhënës ishte marrja e mendimeve të tyre për rëndësinë që ka aparatura didaktike në një tekst shkollor, pajisjen e teksteve me aparaturë, ndërlidhjen e saj me përmbajtjen e tekstit, rëndësinë që kanë ilustrimet, fotot, pyetjet, detyrat dhe fjalorë, si dhe sugjerimet e mësimdhënësve për të ndryshuar aparaturën didaktike gjatë ribotimit ose botimit të teksteve të reja.

3.1. Mendimet e mësimdhënësve për pajisjen e teksteve shkollore me aparaturë didaktike

Në pyetjen se sa janë të pajisura tekstet shkollore, Leximi letrar, me aparaturë didaktike (fotografi, ilustrime, pyetje, detyra, fjalorë etj.), gjysma e mësimdhënësve i kanë vlerësuar

ato si pjesërisht të pajisura, ndërsa një e treta e tyre numër kanë thënë se tekstet shkollore nuk janë të pajisura mjaft me aparaturë didaktike dhe kishte dhe një numër më i vogël i mësimdhënësve kanë vlerësuar se tekstet shkollore janë pak të pajisura me aparaturë didaktike.

Përgjigjet e mësimdhënësve të paraqitura në përqindje




3.2. Mendimet e mësimdhënësve për rëndësinë e aparaturës didaktike

Në pyetjen se cila është rëndësia e aparaturës didaktike në një tekst shkollor, sipas mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim, aparatura didaktike është mjaft e rëndësishme dhe e bën më të lehtë mësimdhënien dhe nxënien në të gjitha etapat e orës.

46 për qind e mësimdhënësve e vlerësojnë si mjaft të rëndësishme aparaturën didaktike në tekstet shkollore, ngase, sipas tyre, e bën më të lehtë shpjegimin në orën mësimore dhe 42 për qind kanë thënë se e bën më të lehtë arritjen e

objektivave, ndërsa 12 për qind e mësimitdhënësve janë deklaruar se aparatura didaktike nuk e lehtëson shpjegimin.


Përgjigjet e mësimitdhënësve për rëndësinë e aparaturës didaktike (ilustrimeve, pyetjeve ,detyrave, fjalorëve) në përqindje



3.3. Mendimet e mësimitdhënësve për ndërlidhjen e aparaturës didaktike me përmbajtjen e tekstit

Për ndërlidhjen e aparaturës didaktike me përmbajtjen e tekstit, rreth gjysma e mësimitdhënësve janë përgjigjur se aparatura didaktike është e ndërlidhur me tekstin, ndërsa pjesa tjetër kanë thënë se është pjesërisht e ndërlidhur, por kishte edhe mësimitdhënës që mendonin se ajo nuk është fare e ndërlidhur me tekstin.

Përgjigjet e mësimeve për ndërlidhjen e aparaturës didaktike me përmbajtjen e tekstit në përqindje.




3.4. Mendimet e mësimeve për rëndësinë e ilustrimeve në tekstet shkollore

Ilustrimet në tekstet shkollore, sipas mësimeve të përfshirë në hulumtim, janë mjaft me rëndësi, prandaj shumica prej tyre u kushtojnë mjaft rëndësi.

Megjithatë, kishte edhe mësime të cilët kanë vlerësuar se, me gjithë rëndësinë që kanë ilustrimet, nuk u kushtojnë shumë rëndësi.

Përgjigjet e mësimeve për rëndësinë që u kushtojnë ilustrimeve të paraqitura në tekste.




3.5. Mendimet e mësimeve për rëndësinë e pyetjeve në tekstet shkollore

Të gjithë mësuesit e përfshirë në hulumtim kanë thënë se gjatë shpjegimit të njësive mësimore u kushtojnë shumë rëndësi pyetjeve që gjenden në tekst, por disa edhe i formulojnë vetë.

Ata janë shprehur se gjatë vlerësimit të njohurive të nxënësve për përmbajtjen mësimore në tekste nxënësve u parashtrojnë më shpesh pyetje të rikujtueses dhe pyetje përmbledhëse dhe më pak pyetje të komentit dhe pyetje kreative.

Përgjigjet e mësimeve për pyetjet që ua parashtrojnë nxënësve më shpesh.



3.6. Sugjerimet e mësimeve për ndryshime të aparaturës didaktike

Mësimeve kanë dhënë sugjerime të ndryshme për ndryshimin e aparaturës në tekstet shkollore, si dhe plotësimin e tyre me aparaturë didaktike më të përshtatshme në të ardhmen.

Në pyetjen se cilat do të ishin tri gjërat më të rëndësishme që do t'i ndryshonit sa i përket aparaturës didaktike në tekstin Leximi letrar, kemi marrë këto përgjigje nga mësimeve e përfshirë në hulumtim: Ilustrimet dhe fotografitë të jenë mundësisht të gjitha me ngjyra dhe të ketë më shumë fotografi dhe ilustrime në mënyrë që të kompletohet njësia mësimore.


Parashtrimi i detyrave në tekst të jetë më i qartë dhe më praktik për nxënësit, ndërsa pyetjet të jenë më shumë me karakter kërkues dhe të nxitin interesimin e nxënësve për mësim.

Puna me fjalorë të jetë më e qartë dhe më praktike, si dhe të ketë më tepër shpjegime për fjalët e panjohura në tekst.

Mësimdhënësit sugjerojnë që tekstet e leximit të jenë më të shkurtra dhe më shumë të pajisura me aparaturë didaktike edukative.

Një kërkesë tjetër e mësimdhënësve ishte që hartimi i teksteve të reja apo rishikimi i teksteve aktuale të jetë i mbështetur më shumë me shembuj praktikë, të cilët ua mundësojnë nxënësve punën e pavarur në mësim.

Sugjerimet e mësimdhënësve për plotësimin e teksteve me aparaturë didaktike.



3.7. Teksti më i mirë, sa i përket aparaturës didaktike, sipas mësimeve


Sipas mësimeve të përfshirë në hulumtim, sa më i pajisur të jetë teksti shkollos me aparaturë didaktike, aq më e lehtë bëhet mësime.

Për të kuptuar se cili tekst shkollos është më i pajisur me aparaturë didaktike, kemi marrë këto vlerësime nga ana e mësimeve.

Më së shumti mësimeve i kanë vlerësuar tekstin Leximi letrar 8 (tekst alternativ) dhe tekstin Leximin Letrar 6, të cilët, sipas tyre, janë më të përshtatshëm për mësime sa i përket aparaturës didaktike.

Një vlerësim të mirë sa i përket aparaturës didaktike mësimeve e kanë dhënë edhe për Leximin Letrar 9, në krahasim me dy tekstet e tjera, Leximin letrar 7 dhe Leximin letrar 8.

Përgjigjet e mësimeve për tekstin më të mirë, sa i përket aparaturës didaktike.



4. Rezultatet e hulumtimit nga pyetësoni me autorë të teksteve

Në shikim të parë hartimi i një teksti shkollor duket punë e thjeshtë, por kur merren parasysh aspektet e ndryshme që duhet t'i përfshijë teksti shkollor, siç është aparatura didaktike, hartimi i tij nuk del të jetë edhe aq i lehtë.

Sipas autorëve të këtyre teksteve, një autor tekstesh, sado i mirë të jetë, pa mbështetjen e recensentëve dhe ilustruesve profesionalë, nuk është në gjendje të përgatisë një tekst me aparaturë të mirë didaktike.

Sa i përket hartimit të teksteve, autorët shprehen se në Kosovë nuk ka pasur traditë për hartimin e tyre, duke u mbështetur në kërkesat dhe nevojat e nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Sipas tyre, deri më tani tekstet kanë kaluar vetëm në duart e recensentëve, por jo edhe të ilustruesve profesionalë.

Në vazhdim po i japim mendimet e autorëve të teksteve në formë narrative për rëndësinë e aparaturës didaktike, për pajisjen e tyre me aparaturë, për ndërlikimin e saj me përmbajtjen dhe përshtatjen me moshën e nxënësve, për ilustrimet, pyetjet, detyrat dhe fjalorët, si dhe sugjerimet për ndryshime ose plotësime në të ardhmen. (Meqenëse numri i autorëve të përfshirë në hulumtim nuk ishte i madh, nuk e pamë të arsyeshme që përgjigjet e tyre t'i paraqesim me anë të grafikoneve).

4.1. Mendimet e autorëve për rëndësinë e aparaturës didaktike në tekstet shkollore

Sipas autorëve të teksteve, aparatura e përshtatshme didaktike e bën më të lehtë tekstin shkollor për mësimdhënësit dhe për nxënësit. E lehtëson tekstin, krijon motivim, asociacione dhe nxitje, e po ashtu i zbërthen çështjet mësimore, i ushtron praktikisht nxënësit, si dhe e bën më të kuptueshëm dhe më të qartë tekstin.

Hartimi i një teksti shkollor, sipas autorëve, nuk duhet të konceptohet pa aparaturë didaktike, sado e vështirë të jetë përzgjedhja e saj.

4.2. Mendimet e autorëve për pajisjen e teksteve me aparaturë didaktike

Të gjithë autorët e përfshirë në hulumtim kanë thënë se i japin hapësirë të mjaftueshme aparaturës didaktike (ilustrimeve, pyetjeve, detyrave, fjalorëve etj.) gjatë hartimit të tekstit shkollor.

Sipas tyre, tekstet shkollore janë të pajisura me aparaturë didaktike, por kanë nevojë të bëhen gjithnjë korrigjime, plotësime, përmirësime. Sidomos pyetjet dhe detyrat t'u përshtaten niveleve të ndryshme të nxënësve.

4.3. Mendimet e autorëve për ndërlidhjen e aparaturës didaktike me përmbajtjen

Të gjithë autorët e teksteve të përfshirë në hulumtim kanë vlerësuar se aparatura didaktike në tekstet shkollore është e

ndërlidhur me përmbajtjen e tekstit. Po ashtu, të gjithë kanë thënë se i japin hapësirë të mjaftueshme aparaturës didaktike (ilustrimeve, pyetjeve, detyrave, fjalorëve etj.) gjatë hartimit të tekstit mësimor.

Sipas autorëve, përgjegjësinë për ndërlidhjen e aparaturës didaktike me përmbajtjen e tekstit e kanë vetë autorët i tekstit, pa përjashtuar edhe recensentët e tekstit dhe botuesit të cilët e kanë një përgjegjësi të madhe në këtë aspekt.

4.4. Mendimet e autorëve për rëndësinë e ilustrimeve, pyetjeve, detyrave dhe fjalorëve

Sipas vlerësimit të autorëve, rëndësinë më të madhe sa i përket aparaturës didaktike në tekstet shkollore e kanë ilustrimet, për faktin se, nëse ato janë të kuptueshme e me vlerë dhe tregojnë qartë domethënien e tyre, ua mundësojnë nxënësve që ta kuptojnë sa më lehtë tekstin.

Megjithatë, ilustrimet në tekstet shkollore duhet të përzgjidhen sipas nevojës dhe jo të ngarkohen tepër, ngase tekstet e mbingarkuara me ilustrime e humbin domethënien e tyre vlerësojnë autorët e teksteve.

Sipas tyre, duhet të kihet parasysh vendosja e ilustrimeve në tekst dhe jo të vendosen vend e pa vend, sepse atëherë teksti do ta humbë rëndësinë e vet praktike.

Në përgjithësi, ilustrimet, pyetjet, detyrat dhe fjalorët në tekstet shkollore vlerësohen si puna më e rëndësishme, por njëkohësisht edhe si më e vështira, andaj autorët gjatë hartimit të teksteve për përzgjedhjen e ilustrimeve do të duhej të merrnin pikëpamjet e piktorëve-ilustruesve.

Mirëpo, praktikisht, përzgjedhjen e ilustrimeve para përpilimit të tekstit 90 për qind e autorëve të përfshirë në hulumtim kanë

thënë se e bëjnë autori dhe ilustruesi së bashku, kurse 10 për qind kanë thënë se e bën vetëm ilustruesi i tekstit.

Autorët në përgjithësi e vlerësojnë rëndësinë e pyetjeve, detyrave dhe fjalorëve në tekst.

Se çfarë pyetjesh duhet të ketë më tepër në fund të njësisë mësimore: të rikujtueses, të komentit apo përmbledhëse, 40 për qind e autorëve mendojnë se duhet të ketë më tepër pyetje të komentit, 40 për qind pyetje përmbledhëse, ndërsa 20 për qind kanë thënë se varet nga niveli i shkollimit (klasa).

Detyrat, sipas tyre, duhet të jenë sa më praktike dhe më të shumta në numër, kurse edhe fjalorët duhet të jenë më të shumtë, bazuar në moshën e nxënësve.

4.5. Mendimet e autorëve për përshtatjen e aparaturës didaktike me përmbajtjen e tekstit

Aparatura didaktike në tekstet shkollore duhet t'u përshtatet njëkohësisht përmbajtjes së tekstit, moshës së nxënësve dhe njohurive paraprake të tyre.

Autorët kanë dhënë mendime të ndryshme sa i përket përshtatjes së aparaturës didaktike me përmbajtjen e tekstit, moshën e nxënësve etj.

10 për qind e tyre kanë thënë se duhet t'i jepet përparësi moshës së nxënësve, 30 për qind përmbajtjes së tekstit, ndërsa gjysma e tyre, apo 50 për qind e autorëve, mendojnë se përparësi duhet t'u jepet kompetencave dhe 10 për qind kanë thënë se nuk duhet të përjashtohen asnjëra.

Po ashtu, edhe kriteri grafik në një tekst shkollor është i rëndësishëm, por deri më tani nuk i është kushtuar mjaft rëndësi. Sa i përket madhësisë së shkronjave (sidomos për nxënësit me nevojë të veçanta), 40 për qind e autorëve kanë

thënë se tekstet janë të përshtatshme, ndërsa 60 për qind kanë thënë se nuk janë të përshtatshme.

Autorët e teksteve në përgjithësi kanë thënë që në të ardhmen duhet të bëhen korrigjime dhe plotësime, në të gjitha aspektet e lartpërmendura, sidomos sa u përket numrit dhe cilësisë së ilustrimeve, si dhe përdorimit të pyetjeve në tekst (të ketë pyetje riprodhuese, komentuese, interpretuese, argumentuese etj).

4.6. Sugjerimet dhe propozimet e autorëve për ndryshime të aparaturës

Mjaft me rëndësi ishin sugjerimet dhe propozimet e dhëna nga vetë autorët e teksteve sa i përket aparaturës didaktike në tekstet shkollore.

Shumica e teksteve shkollore në Kosovë, sipas autorëve, janë shumë tradicionale dhe me një aparaturë didaktike jo të pasur. Mirëpo, sipas tyre, tekstet e fushave të tjera, për dallim nga tekstet e letërsisë, janë edhe më të varfra sa i përket pajisjes me aparaturë didaktike!

Sipas vlerësimeve të tyre, gjatë ribotimit të teksteve aktuale apo hartimit të teksteve të reja, për nivelin e arsimit të mesëm të ulët, pa përjashtuar edhe nivelet e tjera të shkollimit, ka mjaft nevojë për ndryshime dhe përmirësime sa i përket aparaturë didaktike.

Ndër propozimet dhe sugjerimet e tyre ishin:

Ndryshimi i qasjes së hartimit të teksteve, me ç'rast një vend më të rëndësishëm do t'u jepej ilustrimeve, pyetjeve problemore, të thjeshtimit të pyetjeve riprodhuese, detyrave lojë, në mënyrë që ato të jenë rrjedhojë e përmbajtjeve, si dhe të ndihmojnë nxënësit në kuptimin përmbajtjeve të tekstit dhe

mësimdhënësit gjatë shpjegimit. Po ashtu, kriteri grafik t'u përshtatet më tepër fëmijëve me nevoja të veçanta dhe moshës së tyre.

5. Rezultatet nga fokus-grupet me nxënës, mësimdhënësit dhe autorët e teksteve

Në kuadër të hulumtimit, kemi organizuar edhe një punëtori me fokus-grupe, në të cilën kanë marrë pjesë autorët e teksteve, mësimdhënësit dhe nxënësit. Qëllimi i punëtorisë ishte që të merren mendime lidhur me aparaturën didaktike që përmbajnë tekstet shkollore, rëndësisë që i kushtojnë autorët aparaturës didaktike gjatë hartimit të teksteve, si dhe mësimdhënësit dhe nxënësit gjatë procesit mësimor - punës me tekste, etj.

5.1. Mendimet dhe propozimet e nxënësve

Disa nga mendimet, propozimet dhe rekomandimet e dhëna nga ana e nxënësve në punëtori ishin: Ilustrimet të mos jenë shumë konkrete, por më shumë enigmatike.

Sipas tyre, në klasën e tetë dhe të nëntë interesimi për ilustrime është më i vogël, prandaj ka nevojë të ketë më tepër biografi dhe fjalorë në tekste dhe më pak ilustrime.

Fjalorët të jenë më të pasur, ngase ka fjalë në tekste që mungojnë në fjalorë dhe është vështirë të gjinden kuptimet e tyre.

Shembujt të jenë me më tepër ilustrues dhe ilustrimet të jenë në vendin e duhur.

Pyetjet të mos jenë më të shumta në numër në klasën e gjashtë në krahasim me klasat e tjera, sepse është një ngarkesë për nxënësit në këtë moshë.

Nxënësit në fokus-grupe i kanë paraqitur edhe disa nga përparësitë dhe dobësi që i kanë tekstet aktuale sa i përket aparaturës didaktike.

Disa nga përparësitë, si pas tyre, janë:

- Ilustrimet janë, deri diku, të mjaftueshme dhe në të shumtën e rasteve përputhen me përmbajtjen;
- Pyetjet e dhëna në tekste janë të mjaftueshme për ta kuptuar përmbajtjen;
- Tekstet e favorizojnë punën e pavarur të tyre.

Ndërsa mangësitë që përmbajnë këto tekste, sipas tyre, krahasuar me përparësitë, janë më të shumta, si:

- Mungesa e fjalorëve për fjalë të panjohura në disa tekste, apo njësi mësimore;
- Përsëritja e pyetjeve për të njëjtën temë, disa prej së cilave janë edhe jashtë temave mësimore;
- Mungesa e shembujve dhe e figurave letrare;
- Mungesa e biografive për disa autorë;
- Mungesa e detyrave zbavitëse, detyrave lojë;
- Mospërshtatja e shumë poezive me moshën e nxënësve;
- Në klasën e gjashtë teksti ka shumë pyetje.

5.2. Mendimet dhe propozimet e mësimitdhënësve

Mendime dhe propozime mjaft me rëndësi për aparaturën didaktike të teksteve ka dhënë edhe grupi i mësimitdhënësve pjesëmarrës në punëtori.

Disa nga propozimet e mësimitdhënësve ishin:

- Tekstet të jenë të pajisura më shumë me aparaturë didaktike;
- Fjalorët të jetë më të shumtë në numër;
- Pyetjet të jenë analitike dhe sqarimi i figurave letrare të bëhet përmes shembujve konkretë;
- Leximi letrar i klasës së nëntë të jetë më përmbledhës;
- Të vihet në pah rëndësia e periudhave të ndryshme letrare gjatë hartimit të teksteve;
- Të bëhet ndërlidhja e Letërsisë me lëndët e tjera (Histori, Gjeografi, Muzikë, Art);
- Aparatura didaktike t'i plotësojë kërkesat e nxënësve gjatë ribotimit;
- Tekstet të jenë të integruara, letërsi-gjuhë, të kenë korrelacion kuptimor;
- Të bëhet unifikimi i teksteve të Gjuhës shqipe për të gjithë nxënësit shqiptarë;
- Të përputhen pyetjet në tekst me njësitë mësimore;
- Fotografitë dhe ilustrimet të japin edhe mundësi të tjera për mësimdhënësit dhe nxënësit gjatë punës me tekste;
- Të bëhen ndryshime në tekste, në mënyrë që të jenë më të përshtatshme për të arritur kompetencat.

5.3. Mendimet dhe propozimet e autorëve

Autorët e teksteve të përfshirë në fokus-grupe e vlerësojnë shumë aparaturën didaktike, ngase, sipas tyre, ajo ndikon që nxënësit të ndjejnë kënaqësi kur e lexojnë tekstin dhe mësojnë nga ai.

Në vijim po sjellim disa mendime të dhëna nga autorët e teksteve për rëndësinë e aparaturës didaktike dhe propozimet

për ndryshime gjatë hartimit të teksteve të reja shkollore ose ribotimit të teksteve aktuale:

Hartimi i një teksti shkollor nga lënda e Letërsisë nuk është punë e lehtë, ngase librat e leximit është shumë më vështirë të shkruhen sesa tekstet e tjera.

Në krahasim me vitet e nëntëdhjeta, tekstet e leximit letrar kanë ndryshuar, por vërehen akoma probleme, të cilat duhet të eliminohen në të ardhmen, gjatë hartimit të teksteve të reja.

Gjatë hartimit të teksteve rëndësi duhet dhënë edhe aparaturës didaktike, e cila është mjaft me rëndësi në një tekst shkollor dhe gjithnjë t'u përgjigjet kërkesave të nxënësve.

Cilësia e ilustrimeve dhe ndërlidhja aparaturës didaktike me përmbajtjen janë shumë me rëndësi.

Tekstet shkollore të kenë më shumë detyra të karakterit hulumtues, problemeve që kërkojnë zgjidhje.

Një pjesë e fjalëve të panjohura në tekst duhet lënë të shpjegohen vetë nga mësimdhënësit, duke shfrytëzuar edhe burime të tjera, përveç tekstit bazë.

Vokabulari i fjalëve duhet të jetë sipas klasave dhe t'i përgjigjet moshës së nxënësve.

6. Rezultatet nga protokollin e vëzhgimit të mësimdhënësve

Në mënyrë që hulumtimi të jetë më i besueshëm, përveç të dhënave të marra me anë të pyetësorëve dhe punëtorisë me fokus-grupe, kemi vëzhguar mësimdhënësit e Gjuhës shqipe dhe letërsisë në orët mësimore. Gjithsej i kemi vëzhguar tetë

mësimdhënës, nga klasa e gjashtë deri në të nëntën, në katër shkolla, duke i përfshirë katër komuna të ndryshme të Kosovës. Përmes protokollit të vëzhgimit i kemi vrojtuar mësimdhënësit se kur, për çfarë qëllimesh, dhe sa shpesh e përdorin aparaturën didaktike që gjendet në tekstet shkollore (ilustrimet, fjalorët, pyetjet dhe detyrat etj.) gjatë realizimit të një orë mësimore.

Mësimdhënësit e vëzhguar i kemi koduar si ‘mësimdhënësi 1’ dhe ‘mësimdhënësi 2’.

Në vazhdim po i paraqesim rezultatet e dala nga vëzhgimi i mësimdhënësve, sipas klasave.

6.1. Vëzhgimi i mësimdhënësve të klasës së gjashtë

Për të parë se sa i kushtojnë rëndësi aparaturës didaktike në tekstet shkollore (ilustrimeve, fotove, pyetjeve, detyrave dhe fjalorëve), sa e ndërlidhin atë me përmbajtjen e tekstit në një orë mësimore, janë vëzhguar dy mësimdhënës të lëndës Gjuhë dhe letërsi shqipe.

Mësimdhënësi 1

Gjatë vëzhgimit kemi vërejtur se ilustrimet mësimdhënësi i përdor vetëm në fazën e evokimit, për të tërhequr vëmendjen e nxënësve dhe me qëllim që t’ua bëjë më të lehtë përmbajtjen, ndërsa fotove të dhëna në tekst u kushtonte rëndësi në fazën e realizim-kuptimit, gjatë zhvillimit të njësisë mësimore, duke kërkuar nga nxënësit komentimin e tyre, e po ashtu edhe në fazën e reflektimit e bën shpjegimin e ilustrimeve dhe fotove, sipas kërkesave të nxënësve, për t’ua bërë të qartë ilustrimin që nuk e kanë kuptuar sa duhet, varësisht prej grupeve.

Pyetjeve të dhëna në tekst mësimdhënësi u kushtonte rëndësi, për ta mbajtur të zgjuar interesimin e nxënësve gjatë orës, por edhe gjatë reflektimit.

Detyrave në tekst mësimdhënësi kërkonte nga nxënësit t'u përgjigjen në pjesën përfundimtare të orës, për të vlerësuar se sa e kanë kuptuar mësimin e shpjeguar.

Gjatë vëzhgimit kemi vërejtur se mësimdhënësi u përmbahej vetëm pyetjeve dhe detyrave të dhëna në tekst dhe nuk parashtronte pyetje të tjera, e as nuk u jepte detyra jashtë tekstit shkollor.

Mësimdhënësi 2

Ilustrimet dhe fotot mësimdhënësi i përdorte vetëm në fazën e realizim-kuptimit dhe jo në fazat e tjera të orës, duke kërkuar nga nxënësit komentimin dhe shpjegimin e tyre. Ilustrimet i përdorte për t'ua bërë nxënësve më të lehtë përmbajtjen e mësimin dhe për të tërhequr vëmendjen e tyre.

Pyetjeve të dhëna në tekst nuk u kushtonte rëndësi, për dallim prej detyrave, të cilave u kushtonte rëndësi më të madhe dhe i përdorte vetëm ato që ishin të dhëna në tekst.

Pyetjet i përdorte vetëm në pjesën përfundimtare të orës dhe këtë e bënte për të parë se sa e kanë kuptuar nxënësit mësimin. Sa u përket fjalëve të panjohura, mësimdhënësi jepte sqarime vetëm në rastet kur nxënësit pyesin për ndonjë fjalë që nuk e kishin të qartë domethënien e saj.

6.2. Vëzhgimi i mësimdhënësve të klasës së shtatë

Në klasat e shtata janë vëzhguar, po ashtu, dy mësimdhënës të Gjuhës shqipe dhe letërsisë gjatë mbajtjes së orës mësimore.

Mësimdhënësi 1

Ilustrimet mësimdhënësi i përdorte në dy faza të orës mësimore, në evokim dhe në reflektim, për të t'ua lehtësuar përmbajtjen nxënësve dhe për ta mbajtur të zgjuar interesimin e nxënësve, ndërsa ndërlihdjen e ilustrimeve, pyetjeve, detyrave dhe fjalorëve me përmbajtjen e bënte fare ngushtë. Në fazën e realizimit të kuptimit mësimdhënësi zhvillonte diskutime me nxënësit rreth ilustrimeve dhe fotove të paraqitura në tekst, kërkonte interpretimin e tyre, duke marrë mendime të ndryshe nga ta, me qëllim që ta kenë sa më të qartë mesazhin e ilustrimeve të dhëna.

Fjalët e panjohura i shpjegonte vetëm kur nxënësit kërkonin t'ua bënte të njohur kuptimin e tyre. Mësimdhënësi nuk i pyeste fare nxënësit se cilat janë fjalët e panjohura që gjenden në tekst, në mënyrë që të shpjegonte kuptimin e tyre.

Në fund të orës, me kërkesën e një nxënësi, mësimdhënësi u jepte sqarime për disa fjalë të panjohura.

Gjatë vrojtimit kemi vërejtur se mësimdhënësi i kushtonte pak rëndësi fotove dhe grafikoneve të paraqitura në tekst, ndërsa pyetjeve të dhëna nuk u përmbahej në tërësi, por vetëm disave gjatë fazës së reflektimit.

Sa u përket detyrave, në fund të orës, mësimdhënësi u jepte nxënësve vetëm detyrat që gjenden në tekst dhe jo detyra të tjera.

Mësimdhënësi 2

Gjatë shpjegimit, mësimdhënësi nuk ndalej shumë tek ilustrimet e dhëna në tekst dhe nuk e bënte ndërlihdjen e tyre me përmbajtjen, për t'ua bërë më të lehtë kuptimin e mësimimit.

Mësimdhënësi nuk zhvillonte diskutime për ilustrimet dhe fotot e dhëna në tekst, me qëllim që nxënësit ta ndihmonin njëri-tjetrin dhe nuk kërkonte nga nxënësit që të paraqesin mendimet rreth ilustrimeve të dhëna, për të marrë mendimet e tyre se çfarë mesazhi jep ilustrimi i dhënë.

Ndërsa, fjalët e panjohura që gjenden në tekst i sqaronte vetëm në rastet kur kërkonin nxënësit, pasi mësimdhënësi nuk e shihte të nevojshme ta bënte një gjë të tillë gjatë shpjegimit.

Për ta mbajtur të zgjuar interesimin e nxënësve, mësimdhënësi kërkonte nga nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve që gjenden në tekst, kurse në fund të orës kërkonte t'i zgjidhin dy detyra të dhëna në tekst nga autori, për ta parë se sa nxënësit e kanë kuptuar mësimin. Detyrat e shtëpisë nuk ua jep ato që janë në tekst, por i formulonte vetë.

6.3. Vëzhgimi i mësimdhënësve të klasës së tetë

Mësimdhënësi 1

Ilustrimet dhe fotot e dhëna në tekst mësimdhënësi i përdorte kryesisht në fazën e evokimit, por edhe në fazat e tjera të orës, duke e bërë ndërlidhjen e tyre me përmbajtjen, me qëllim që nxënësve t'ua lehtësojë të kuptuarit e përmbajtjes.

Diskusime me nxënës për ilustrimet e dhëna në tekst bënte në të gjitha fazat e orës, për të kuptuar se sa nxënësit e kanë të qartë ilustrimin, duke kërkuar nga ta të bënin komentimin e tyre dhe të tregonin mesazhin e dhënë në ilustrim. Pra, mësimdhënësi u kushton mjaft rëndësi fotove dhe ilustrimeve të dhëna në tekst.

Po ashtu, edhe pyetjeve në tekst u përmbahej kur i pyeste nxënësit për përmbajtjen, ndërsa gjatë zhvillimit të njësisë mësimore kërkonte nga nxënësit t'i zgjidhin disa nga detyrat e dhëna në tekst.

Detyrat e shtëpisë për nxënësit mësimdhënësi i formulonte vetë, mbështetur në përmbajtjen e njësisë së zhvilluar, dhe nuk i merrte për bazë detyrat e dhëna në tekst.

Sa u përket fjalëve të panjohura, apo fjalëve të reja në tekst, mësimdhënësi u jepte sqarime nxënësve vetëm në rastet kur nxënësit pyesin për ndonjë fjalë.

Mësimdhënësi 2

Ilustrimeve dhe fotove në tekst mësimdhënësi u kushtonte rëndësi gjatë shpjegimit të njësisë mësimore, duke bërë ndërlidhjen e tyre me përmbajtjen e tekstit.

Mësimdhënësi kërkonte nga nxënësit t'i komentojnë ilustrimet që gjinden në tekst, për të parë se sa e kanë të qartë mesazhin e dhënë në ilustrim, në fazën e realizimit dhe atë të reflektimit të orës mësimore. Me ndihmën e mësimdhënësit, nxënësit e plotësonin njëri-tjetrin, në mënyrë që mesazhi i dhënë në ilustrim të kuptohet drejt.

Gjithashtu, mësimdhënësi i përdorte vetëm pyetjet e dhëna në tekst kur i vlerësonte nxënësit rreth njësisë mësimore, në fazën e realizimit të kuptimit, por edhe në fazën e reflektimit të orës.

Mësimdhënësi nuk kërkonte nga nxënësit t'i zgjidhnin detyrat e dhëna në tekst nga autori i tekstit. Edhe detyrat e shtëpisë për nxënësit i formulonte vetë dhe nuk bazohej në detyrat e dhëna në tekst.

Për fjalët e panjohura, të dhëna në tekst, nuk diskutonte me nxënësit fare dhe nuk u jepte sqarime për asnjë fjalë të panjohur, apo shprehje të re, që përmbante njësia e zhvilluar.

As nxënësit nuk pyesnin për ndonjë fjalë panjohur brenda njësisë mësimore të zhvilluar.

6.4. Vëzhgimi i mësimdhënësve të klasës së nëntë

Mësimdhënësi 1

Mësimdhënësi ilustrimet në tekst i përdorte me qëllim që nxënësit të kuptonin më lehtë njësinë mësimore dhe me qëllim të ndërlikimit të tyre me përmbajtjen.

Fotove, po ashtu, mësimdhënësi u kushtonte rëndësi vetëm në fillim të orës, gjatë fazës së evokimit. U lejonte nxënësve të bënin diskutime për ilustrimet në tekst, për të parë sa e kanë të qartë mesazhin e dhënë në ilustrim, por u jepte pak kohë të shprehnin mendimet e tyre dhe të plotësonin njëri-tjetrin.

Gjatë shpjegimit të njësisë mësimore mësimdhënësi i shpjegonte fjalët e panjohura dhe shprehjet e reja në tekst, por vetëm kur kërkonin nxënësit shpjegimin e ndonjë fjale të panjohur të përdorur nga autori.

Ndërsa, gjatë vlerësimit të njohurive të nxënësve për përmbajtjen e njësisë mësimore të zhvilluar, u përmbahej pyetjeve në tekst, veçanërisht gjatë fazës së reflektimit, dhe nuk u parashtronte pyetje të tjera.

Mësimdhënësi i angazhonte nxënësit t'i zgjidhin detyrat e dhëna në tekst në përfundim të orës mësimore dhe ua jepte t'i plotësonin për detyrë shtëpie.

Mësimdhënësi 2

Për të tërhequr vëmendjen e nxënësve dhe me qëllim që t'ua bëjë më të lehtë përmbajtjen e mësimin, mësimdhënësi i

përdorte ilustrimet dhe fotot në fazën e evokimit të orës, për të parë se a e kanë të qartë të gjithë nxënësit ilustrimin dhe foton e dhënë në tekst. Po ashtu, kërkonte domethënien e ilustrimeve nga nxënësit, i pyeste se për çfarë janë dhënë ilustrimet në tekst, çfarë kuptojnë me to dhe cili është mesazhi i tyre.

Pyetjeve në tekst u përmbahej plotësisht, duke mos bërë pyetje të tjera për nxënësit në fazën e realizimit të kuptimit dhe as në fazat e tjera të orës.

Gjithashtu, edhe detyrat e dhëna në tekst kërkonte nga nxënësit t'i zgjidhnin, e po ashtu edhe për detyrë shtëpie ua jepte nxënësve ashtu siç i ka dhënë autori i tekstit.

Sa u përket fjalëve dhe shprehjeve të panjohura, disa nxënës bënë pyetje dhe arsimitari u përgjigjej atyre, në fazën e realizimit të kuptimit dhe atë të reflektimit, por nuk e shihte të nevojshme të jepte sqarime për fjalët e panjohura dhe shprehjet e reja edhe pa pyetur nxënësit fare.

6.5. Rezultatet e përgjithshme nga vëzhgimi i mësimdhënësve

Bazuar në rezultatet e përgjithshme të dala nga vëzhgimi, përdorimit të aparaturës didaktike në tekstet shkollore, mësimdhënësit i kushtojnë mjaft rëndësi gjatë shpjegimit në orët mësimore. Do të thotë, aparatura didaktike gjen zbatim në të gjitha fazat e orës, diku më shumë e diku më pak.

Kemi vërejtur se mësimdhënësit u kushtojnë më së shumti rëndësi ilustrimeve dhe fotove në tekst, me qëllim të lehtësimit të përmbajtjes për nxënësit.

Mësimdhënësit gjatë orës mësimore nxisin diskutime për ilustrimet e dhëna në tekst, për të parë sa e kanë të qartë

nxënësit mesazhin e dhënë në ilustrim, megjithëse nuk u japin kohë të mjaftueshme nxënësve për të shprehur mendimet e tyre dhe për të plotësuar njëri-tjetrin në argumentimet e tyre.

Po ashtu, numri më i madh i mësimdhënësve të vëzhguar u kushtojnë rëndësi edhe fjalëve të panjohura, pyetjeve, detyrave dhe pjesëve të tjera të aparaturës didaktike.

Fjalëve të panjohura dhe shprehjeve të reja në tekste pjesa më e madhe e mësimdhënësve u kushtojnë rëndësi gjatë shpjegimit, por këtë më tepër e bëjnë në rastet kur nxënësit kërkojnë shpjegimin e ndonjë fjale që nuk e kanë kuptuar dhe nuk u japin sqarime nxënësve për të gjitha fjalët e panjohura dhe shprehjet e reja të dhëna në tekste nga autorët.

Pyetjeve të dhëna në tekst nga autorët u përmbahen gati të gjithë mësimdhënësit gjatë vlerësimit të njohurive të nxënësve për përmbajtjen e njësisë së zhvilluar mësimore dhe fare pak i hartojnë pyetjet vetë. Vetëm disa mësimdhënës u bëjnë nxënësve pyetje që nuk gjenden në tekst, duke i formuluar vetë, bazuar në njësinë mësimore të zhvilluar.

Po ashtu, mësimdhënësit kërkojnë nga nxënësit t'i zgjidhin detyrat e dhëna në tekst nga autori, zakonisht në fund të orës mësimore, dhe nuk japin detyra të tjera, bazuar në përmbajtjen e tekstit - njësisë së shpjeguar.

Si përfundim, mund të thuhet se pothuajse të gjithë i kushtojnë rëndësi aparaturës didaktike dhe nuk vërehet ndonjë dallim i madh te mësimdhënësit sa i përket përdorimit të saj në orën e mësimimit, gjatë shpjegimit të njësive mësimore.

Të gjithë mësimdhënësit e vëzhguar i përdornin ilustrimet dhe fotot, pyetje, detyrat dhe fjalorët e dhënë në tekst në funksion të lehtësimit të përmbajtjes.

IV. ANALIZA E REZULTATEVE TË PËRGJITHSHME TË HULUMTIMIT

Pas paraqitjes së rezultateve ndaras, të dala nga analiza kabinetike, të gjeturat nga terreni (me anë të pyetësorëve), punëtorja me fokus-grupe, vëzhgimi i mësimdhënësve në orët e mësimimit, po i paraqesim edhe rezultatet e përgjithshme të hulumtimit sa i përket aparaturës didaktike në tekstet shkollore: pajisjen e tyre me ilustrime, pyetje, detyra, fjalorë etj.; rëndësinë që i kushtohet nga autorët e teksteve gjatë hartimit të tyre dhe nga mësimdhënësit dhe nxënësit gjatë orës mësimore.

Rezultatet e përgjithshme i kemi nxjerrë nga analiza e teksteve; intervistat e zhvilluara me autorë të teksteve, mësimdhënës dhe nxënës; punëtorja e mbajtur me fokus-grupe dhe vëzhgimet që ua kemi bërë mësimdhënësve në orë të mësimimit.

Sipas këtyre rezultateve, të dala nga hulumtimi me nxënës, mësimdhënës dhe autorë të teksteve, tekstet aktuale Leximi letrar (klasat 6,7, 8 dhe 9) në përgjithësi janë të hartuara sipas kriterëve, por e njëjta gjë nuk mund të thuhet edhe sa i përket aparaturës didaktike, ngase në disa tekste ajo nuk është e mjaftueshme dhe nuk gjendet në çdo njësi mësimore.

Nga analiza e përgjithshme e rezultateve të hulumtimit mund të konstatojmë se rëndësia e aparaturës didaktike në tekste shkollore vlerësohet mjaftë nga nxënësit, mësimdhënësit dhe autorët e teksteve.

Aparatura e përshtatshme didaktike në tekstet shkollore është mjaft e rëndësishme, për faktin se e bën më të lehtë tekstin, si për mësimdhënësit ashtu edhe për nxënësit.

- Rëndësia e aparaturës didaktike vlerësohet nga nxënësit, për faktin se e lehtëson të kuptuarit dhe ndihmon në zbërthimin e çështjeve mësimore, duke e bërë tekstin më të kuptueshëm dhe më të qartë.
- Mësimdhënësit aparaturën didaktike e vlerësojnë të rëndësishme gjatë shpjegimit dhe interpretimit të përmbajtjes në tekst. Kjo është vërejtur edhe gjatë vëzhgimit të tyre në orët mësimore. Pjesa dërrmuese e mësimdhënësve e shfrytëzojnë aparaturën didaktike të paraqitur në tekst, në funksion të kuptimit më të lehtë të përmbajtjes nga nxënësit.
- Autorët e teksteve e vlerësojnë aparaturën didaktike dhe gjatë hartimit të teksteve përpiqen t'i kushtojnë rëndësi përzgjedhjes së saj, por mungon bashkëpunimi i mirëfilltë me ilustruesit e tekstit dhe recensentët, megjithëse roli i tyre në përzgjedhjen e aparaturës didaktike është i pazëvendësueshëm për përcaktimin e kriterëve të përzgjedhjes së aparaturës, aspektit shpjegues dhe interpretues etj.

Nga analiza e përgjithshme e rezultateve të hulumtimit mund të konstatojmë se vlerësohet mjaft nga nxënësit, mësimdhënësit dhe autorët e teksteve ilustrimet, fjalorët, pyetjet, detyrat dhe shembujt.

Duke e ditur se jo çdo ilustrim e ka të njëjtën rëndësi, ato duhet të përzgjidhen dhe të ndërliken sa më shumë me përmbajtjen mësimore, por rezultatet e hulumtimit tregojnë se:

- Tekstet e Leximit letrar në përgjithësi përmbajnë ilustrime, por në disa prej tyre këto ilustrime nuk janë tërësisht të lidhura me përmbajtjen e tekstit.
- Gjithashtu, përshtatja e ilustrimeve me informacionin e transmetuar jo gjithëherë kanë lidhje të vazhdueshme

ndërmjet vete. Në disa raste nuk e bartin informacion plotësues në lidhje me tekstin - përmbajtjen e tij.

- Mungojnë ilustrimet nga jeta shkollore (fotografitë), që ilustrojnë botën që na rrethon.
- Ilustrimet nuk janë zgjedhur të gjitha në pajtim me moshën e nxënësve. P.sh., libri i klasës së nëntë ka më tepër ilustrime, ndërsa libri i klasës së gjashtë ka më së paku ilustrime, e që do të duhej të ishte e kundërta.

Gjatë analizës së teksteve shkollore kemi vërejtur se ilustrimet e paraqitura në këto tekste janë pika më e dobët e tyre. Disa ilustrime të paraqitura nuk kanë ndonjë domethënie të madhe, nuk ndërlidhen tërësisht me përmbajtjen e tekstit, nuk e zhvillojnë kreativitetin e nxënësve dhe nuk i nxisin as mësimdhënësit që të bëjnë komentimin apo shpjegimin e domethënies së tyre!

Rëndësia e fjalorëve në tekstet shkollore vlerësohet nga mësimdhënësit dhe nxënësit, ngase u referohen atyre gjatë shpjegimit dhe e bëjnë më të lehtë punën me tekstin.

- Fjalorët e paraqitur në tekste luajnë rol të madh në shpjegimin e fjalëve të panjohura, por autorët gjatë hartimit të teksteve nuk kanë dhënë mjaft fjalorë (fjalë të panjohura);
- Autorët janë përpjekur të përdorin gjuhë të qartë dhe të saktë, sipas moshës së nxënësve, duke i përshkallëzuar fjalët sipas klasave. Megjithatë, fjalorët nuk janë të mjaftueshëm dhe nuk gjenden në çdo njësi mësimore.

Rëndësia e pyetjeve dhe detyrave është e madhe, nëse hartohen mirë dhe janë në funksion të zbërthimit të përmbajtjeve.

- Kur tekstet përmbajnë pyetje dhe detyra të karakterit hulumtues, pyetje kërkimore dhe detyra problemore më atraktiv tekstin për nxënësit dhe më të lehtë për mësimdhënësin;
- Pyetjet dhe detyrat janë të rëndësishme për nxënësit dhe për mësimdhënësit, për faktin se u ndihmojnë të kuptojnë faktet e dhëna në tekst, sidomos pyetjet problemore, që kërkojnë zgjidhje dhe që i nxitin nxënësit për të mësuar dhe ndikojnë në zhvillimin e mendimit të pavarur dhe kritik.

Rëndësi të madhe për nxënësit dhe mësimdhënësit sa i përket aparaturës didaktike kanë edhe shembujt e dhënë në tekstet shkollore.

- Shembujt e dhënë e lehtësojnë përdorimin e tekstit, si për nxënësit po ashtu edhe për mësimdhënësit;
- Jo të gjitha autorët gjatë hartimit të teksteve kanë dhënë shembuj të mjaftueshëm, të cilët do ta lehtësonin procesin e të nxënit nga nxënësit.

Bazuar në rezultatet e hulumtimit, konstatojmë se hartimi i një teksti shkollor nuk duhet të konceptohet pa aparaturë didaktike, sado e vështirë të jetë për autorët përzgjedhja e saj.

Edhe vetë autorët e teksteve shkollore Leximi letrar vlerësojnë se tekstet nuk janë të pajisura mjaft me aparaturë didaktike, ngase gjatë hartimit të tyre më shumë i kushtojnë rëndësi përmbajtjes sesa aparaturës didaktike.

Gjatë analizës së teksteve kemi vërejtur se, në disa raste, ka shpërpjesëtim sa i përket përfshirjes së aparaturës didaktike në krahasim me përmbajtjen e teksteve.

Po ashtu, rezultatet e hulumtimit tregojnë se edhe teksteve shkollore që përmbajnë aparaturë didaktike të mjaftueshme: ilustrime, pyetje, detyra, fjalorë, shembuj etj., nuk u kushtohet çdoherë rëndësi gjatë përdorimit, as nga mësimmhënësit dhe as nga nxënësit.

1. Përfundimet

Hipoteza ‘Aparatura didaktike në tekstet shkollore e lehtëson të kuptuarit e tekstit’ është e vlefshme. Këtë interpretim (pohim) e mbështetin përgjigjet e të tre faktorëve të përfshirë në hulumtim (nxënësit, mësimmhënësit dhe autorët e teksteve).

Nga analiza e rezultateve të dala nga hulumtimi me grupet e interesit, mund të themi se një ndërhyrje për përmirësim të aparaturës didaktike në tekstet shkollore është më se e nevojshme. Rishikimi dhe begatimi i teksteve shkollore me aparaturë didaktike është bërë tashmë nevojë e kohës dhe pothuajse e domosdoshme që tekstet të ndryshohen edhe në aspektin përmbajtjesor.

Shtëpitë botuese, autorët e teksteve dhe recensentët duhet t’i kushtojnë rëndësi më të madhe aparaturës didaktike dhe të marrin parasysh kërkesat e nxënësve dhe të mësimmhënësve gjatë ribotimit të teksteve shkollore ose hartimit të teksteve të reja.

Kurrikula mundëson përdorimin e burimeve alternative gjatë procesit të mësimmhënies-nxënies, por teksti shkollor, i hartuar për nxënës, mbetet burimi kryesor i mësimmhënies dhe nxënies, prandaj nevojitet bashkëpunim më i madh i hartuesve të kurrikulës me autorët e teksteve dhe me mësimmhënësit, në

mënyrë që teksti të jetë i pranuar nga mësimdhënësit dhe për nxënësit.

Teksti shkollor, nëse pajiset me aparaturë didaktike adekuate, e lehtëson të kuptuarit e përmbajtjes, krijon motivim dhe nxitje për zbërthimin e çështjeve mësimore dhe e bën më atraktiv si për nxënësit po ashtu edhe për mësimdhënësit.

Në bazë të rezultateve të hulumtimit, ilustrimet fjalorët, pyetjet dhe detyrat janë elementet më të rëndësishme në një tekst shkollor.

Ilustrimet e zgjedhura drejt e plotësojnë shumë konceptin teorik, të ofruar në përmbajtje, mirëpo jo në të gjitha tekstet e përfshira në hulumtim janë të përzgjedhura drejt dhe të lidhura tërësisht me përmbajtjen.

Fjalorët janë mjaft me rëndësi që nxënësit të kuptojnë më lehtë përmbajtjen e tekstit, por në disa tekste janë të paktë në numër ose mungojnë tërësisht në disa njësi mësimore.


Pyetjet dhe detyrat janë orientuese për mësimdhënësit dhe nxënësit, prandaj duhet të jenë sa më atraktive, motivuese dhe të hartuara mbështetur në moshën e nxënësve dhe objektivat e caktuar brenda njësisë mësimore. Vërehet se mungojnë detyrat lojë dhe pyetjet që do të krijojnë motivim të nxënësve, më shumë hasim pyetje riprodhuese ose të rikujtesës, por jo gjithmonë duke filluar nga pyetjet e thjeshta drejt pyetjeve problemore që nxisin kreativitetin e nxënësve dhe mendimin e pavarur e kritik të tyre.

Megjithëse “mjeshtëria” e hartimit të tekstit shkollor nuk mësohet në asnjë fakultet, në asnjë lëndë, duke u mbështetur në praktikat e mira të hartimit të teksteve shkollore në vendet e tjera, duhet që mësimdhënësit fillimisht të jenë bashkautorë e më vonë vetë autorë tekstesh, në mënyrë që tekstet shkollore të

jenë më cilësore dhe të pajisura me aparaturë didaktike të mjaftueshme.

Në mënyrë që të gjinden zgjidhjet më të mira dhe më të pranueshme për hartimin e teksteve shkollore në të ardhmen, sidomos plotësimit me aparaturë didaktike, autori i tekstit shkollor duhet të ketë parasysh mjedisin në të cilin gjenden nxënësit dhe mësimitdhënësit, ndikimin mediatik - mundësitë e shfrytëzimit të mediave të shkruara dhe elektronike nga nxënësit dhe mësimitdhënësit, mundësitë e përdorimit të strategjive bashkëkohore gjatë punës me tekst.

Gjithashtu aparatura didaktike e përdorur në tekste (ilustrimet, pyetjet, detyrat, fjalorët dhe pjesët e tjera) duhet të krijojë mundësi që mësimitdhënësit të shpjegojnë mësimin duke hulumtuar dhe nxënësit të mësojnë duke zgjidhur probleme dhe duke lozur.



Ky hulumtim shpresojmë se do të ndihmojë sadopak në përmirësimin e teksteve shkollore në të ardhmen, gjatë ribotimit apo hartimit të teksteve të reja.

2. Rekomandimet

Të jepen rekomandime për hartimin e teksteve shkollore nuk është gjë e lehtë, por duke u bazuar në rezultatet e dala nga hulumtimi, përgjigjet e nxënësve, mësimitdhënësve dhe autorëve të teksteve, kemi nxjerrë disa rekomandime, të cilat mendojmë se janë të rëndësishme për hartimin e teksteve të reja, apo ribotimin e teksteve aktuale, sa i përket aparaturës didaktike.

Rekomandimet i kemi ndarë për Ministrinë e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, si institucion përgjegjës, për botuesit dhe për autorët e teksteve.

Për MASHT-in

- Të ketë tekste alternative për çdo klasë, ngase alterteksti e rrit autonominë e shkollave (mësimitdhënësve), duke u dhënë mundësi të zgjedhin tekstin me të cilin do të punojnë;
- Recensentë të teksteve shkollore të përzgjidhen njerëzit profesionalë, në mënyrë që tekstet të jenë sa më profesionale dhe jo me aparaturë të varfër didaktike;
- Të ketë një sektor të veçantë, me njerëz profesionistë, i cili merret vetëm me tekstet shkollore, në mënyrë që

procesi i përzgjedhjes së teksteve të jetë më cilësor dhe të kalojnë nëpër disa “filtra”, para se t’u jepet leja për botim;

- Të marrë parasysh rezultatet e hulumtimeve me mësimdhënës dhe nxënës, në mënyrë që të evidentohen tekstet shkollore që nuk përmbajnë aparaturë të mjaftueshme didaktike, para se të hiqen nga përdorimi dhe të zëvendësohen me tekste të reja.

Për botuesit e teksteve

- Shtëpitë botuese t’i përmirësojnë tekstet nga aspekti i aparaturës didaktike, sidomos gjatë rishikimit të tyre dhe hartimit të teksteve të reja;
- Në bashkëpunim me autorët e teksteve dhe komponentët e tjerë, të organizojnë trajnime për mësimdhënësit, si dhe të mbajnë lidhje të vazhdueshme me ta, për t’u formuar një hallkë e rëndësishme, e cila e ndihmon procesin e rishikimit të teksteve dhe përmirësimin e tyre;
- Të respektojnë sugjerimet e autorëve, të mësimdhënësve dhe të nxënësve, për përmirësimin e teksteve, sa i përket aparaturës didaktike.

Për autorët e teksteve

- Të ndërlidhin aparaturën didaktike në çdo tekst me përmbajtjen, ngase kjo është shumë me rëndësi në tekstet shkollore;

- T'i kushtojnë rëndësi moshës së nxënësve gjatë hartimit të teksteve dhe nivelit të shkollimit;
- Përzgjedhjen e ilustrimeve ta bëjnë së bashku me ilustruesit;
- Të formulojnë më tepër detyra të karakterit hulumtues dhe pyetje kërkimore;
- Tekstet të përmbajnë më tepër fjalorë (fjalë të panjohura), në mënyrë që nxënësit të kuptojnë më lehtë fjalët e panjohura dhe shprehjet e reja;
- Të përdorin më shumë shembuj që ua mundësojnë nxënësve të kuptuarit sa më të lehtë të përmbajtjes.

BIBLIOGRAFIA

Bekteshi, Bektesh (2005), *Statistika Elementare*, “Libri shkollor”, Prishtinë.

Biehler, F. Robert, Jack Snowman (2004), *Psikologjia e zbatuar në mësimdhënie*, ISP, “Nënë Tereza”, Tiranë.

Bruner, Jerome (2003), *Kultura e edukimit*, ISP, Tiranë.

Fjalor i Shqipes së Sotme (2002), ASHSH, IGJL, “Toena”, Tiranë.

Gardner, H. (2003), ‘Mendja e Pashkolluar’, ISP ‘Eureka’, Tiranë.

Gardner, H. (2003), ‘Dimensionet e Mendjes’ (ISP ‘Eureka’, Tiranë.

Grillo Kozma (2002), *Fjalor Edukimi (Psikologji – Sociologji-Pedagogji)*, ISP, Tiranë.

Instituti i Studimeve Pedagogjike (2003), “Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore”, Tiranë.

Kocani, Aleksandër (2009), *Metodat e kërkimit sasior në shkencat sociale*, ‘UFO press’, Tiranë.

Leximi, shkrimi dhe diskutimi në çdo lëndë (2001), udhëzues nr. 3, KEC, Prishtinë.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2007), *Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007-2017*, Prishtinë.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2010), *Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016*, Prishtinë.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2011), *Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-032*, Prishtinë.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë (2006), “Konceptioni për tekst shkollor të arsimit fillor dhe të mesëm”, Manastir, SHA "Kiro Dandaro".

Murati, Xheladin (2004), *Metodologjia e kërkimit*. “Çabej”, Tetovë.

Musai, Bardhyl (2003), *Metodologji e mësimdhënies*, “Pegi”, Tiranë.

Osmani, Shefik (1983), *Fjalor i pedagogjisë*, “8 Nëntori”, Tiranë.

Pollak Myra & Miller, David, (1994), *Mësuesit, shkolla dhe shoqëria*, Tiranë.

Publication Manual of the American Psychological Association (2002), Fifth Edition (APA), Uashington, DC.

Ramaj, Abdyl (2001), *Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor*, ‘Libri Shkollor’, Prishtinë.

Seminari për të shkruarit, “Nga të vetëshprehurit tek argumentet e shkruara”, (2001), udhëzues nr. 7, KEC, ARA, Prishtinë.

Strukturë për zhvillimin e mendimit kritik gjatë kurrikulumit (2001), udhëzues nr. 1, KEC, Prishtinë.

Zajazi, Tahir (2003), *Metodologjia të mësimdhënies dhe e mësimnxënies (Strategji & Teknika për Rivendosjen e Shkollës)*, EJJ, Shkup.

Tekstet bazë

Petro Rita - Syla Xhevat (2005), ‘Leximi 6’, ‘Albas’, Tiranë.

Kumnova Mazllom - Hyseni Munish (2009), ‘Leximi 7’, ‘Libri shkollor’, Prishtinë.

Kumnova Mazllom - Hyseni Munish (2009), ‘Leximi letrar 8’, ‘Libri shkollor’, Prishtinë.

Rrahmani Kujtim (2008), 'Leximi 8', 'Albas', Tiranë.

Demolli Arif - Syla Xhevat (2009), 'Leximi letrar 9', 'Libri shkollor', Prishtinë.

Burime nga interneti

<http://www.masht-gov.net>

<http://www.mash.gov.al>

www.mash.gov.al/kurikulat

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi

Shtypshkronja "Blendi", Prishtinë

Tirazhi:500 copë

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

37.02(496.51)(047)

Azemi, Bashkim

Aparatura didaktike në tekstet shkollore / Bashkim Azemi & Bekim Morina. - Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2013. - 80 f.: ilustr. ; 22 cm.

Parathënie : f. 7-8. - Bibliografia: f. 77-79

ISBN 978-9951-591-11-9